

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

**“Ehli Bejti është sikur anija e Nuhut. Kush hypë në
te shpëton, e kush mbetet jashtë përmytet.”**


Hadithi-sherif - [Ahmed b. Hanbel, el-Musned, 3/157;
Hakim, el-Mustedrek,

Titulli i origjinalit: Kurtuluş gemisi – Ehl-i Beyt
Në ballinë: Xhybeja e Hz. Husejnit [r.a.]
Përgatiti dhe përktheu: Is-hak Shala dhe Artan Sadiku
Përgatitja kompjuterike: Artan Sadiku
Lektor: Haxhi Iskender Rashiti
Dizajni: Burim Rexhepi

Prishtinë, 2012

Anija e shpëtimit

Ehli Bejti



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	7
------------	---

KAPITULLI I PARË

DRITA E SYVE: EHLI BEJTI

Kush është Ehli Bejti i Hz. Pejgamberit?.....	9
Sejjidët dhe Sherifët e ditëve tona	
Ç' do të thotë Sejjid?	9
Ç' do të thotë Sherif?	11
Sejjidët dhe sherifët në histori.....	12
Ehli Bejti në Perandorinë Osmane.....	13

KAPITULLI I DYTË

AMANETI I HZ. PEJGAMBERIT: EHLI BEJTI

Trashëgimtarët e vërtetë të Hz. Pejgamberit.....	15
Dy amanetet e Hz. Pejgamberit.....	17
Të dalurit zot dy amaneteve të Hz. Pejgamberit.....	18
Sevap i pafund.....	19
Qëndrimi ynë ndaj Ehli Bejtit.....	20
Kështu duhet Ehli Bejti.....	22
Brenda edep, jashtë edukim.....	26
Dhuntia e Allahut.....	27

KAPITULLI I TRETË

EHLI BEJTI DHE VLERAT E TYRE TË LARTA

Ehli Bejti është i zgjedhur.....	29
Më i ngrituri i çdo drejtimi.....	31
A është Ehli Bejti pa gjynahe?	32
Vlerat e larta [fazileti] të Ehli Bejtit.....	34
Ehli Bejti është sikur anija e Nuhut.....	35
Lëkura që duhet puthur.....	37

KAPITULLI I KATËRT

SIGURIA NË DASHURINË NDAJ EHLI BEJTIT

Siguria në dashurinë ndaj Ehli Bejtit.....	39
Dashuria ndaj Ehli Bejtit është farz.....	41
Vlera e veçantë e dashurisë ndaj Ehli Bejtit.....	42
Shpërblimi për dashurinë ndaj Ehli Bejtit.....	44
Dashuria ndaj Ehli Bejtit – shenjë e imanit dhe shkak e shkuarjes me iman.....	45
Matja e dashurisë ndaj Ehli Bejtit.....	47

Dashuria e tërësishme për Ehli Bejtin i është bërë nasib [i është dhënë] Ehli sunnetit.....	50
Në cilin grup jeni ju?	53

KAPITULLI I PESTË

DASHURIA E TË MËDHENJËVE NDAJ EHLI BEJTIT

Dashuria e as'habëve ndaj Ehli Bejtit.....	55
Dashuria e Hz. Ebu Bekrit ndaj Ehli Bejtit.....	56
Dashuria e Hz. Omerit r.a. ndaj Ehli Bejtit.....	58
Dashuria e Hz. Osmanit r.a. për Ehli Bejtin.....	60
Dashuria e të mëdhenjve për Ehli Bejtin.....	60
Imam Azami – Ebu Hanifja.....	60
Imam Maliku.....	61
Imam Shafiu.....	62
Imam Shafiu dhe Sejvide Nefisja.....	63
Imam Ahmed b. Hanbeli.....	64
Ma jep besën!	64

KAPITULLI I GJASHTË

AHLAKU I EHLI BEJTIT

Ahlaku i Ehli Bejtit.....	67
Mirësjellja e Ehli Bejtit.....	68
Merhameti i Ehli Bejtit.....	70
Falja e Ehli Bejtit.....	71
Fytyra e buzëqeshur e Ehli Bejtit.....	73
Modestia e Ehli Bejtit.....	74
Ndruajtja e Ehli Bejtit.....	76
Xhymertllëku [bujaria] i Ehli bejtit.....	76
Takvaja [devotshmëria] e Ehli Bejtit.....	80
Sabri [durimi] i Ehli Bejtit.....	82
Shukri [falënderimi] i Ehli Bejtit.....	84

KAPITULLI I SHTATË

PROVUESHMËRIA E EHLI BEJTIT

Rruga e afërsisë së Hz. Pejgamberit.....	87
Mburra me rrejardhjen familjare dhe fisnikëria.....	90
Hz. Pejgamberi është shembull.....	92
Nëse gjyshi më kapë për jake.....	94
Paralajmërimi i Hz. Pejgamberit.....	94
Pse mburra?.....	96
Me çfarë uji do ta pastrosh egon e ndyrë?	98
Gracka e madhe e shejtanit.....	99
Këshilla e Jakuti Arshit një sejjidi.....	101

HYRJE

Falënderimi i përket Atij që na krijoi, që na mbanë në jetë, që me Islam na ngriti e lartësoi, më të Mëshirshmit të Mëshiruesve, Rabbit të të gjithë botëve, Allahut Teala.

Salat dhe selam i qoftë të dërguarit - mëshirë për të gjithë botët, robit më të dashur të Allahut, Diellit të evlijave, Hënës së plotë të pasuesve të sunnetit të tij, prijësit të pejgamberëve, Hz. Muhammed Mustafasë [s.a.v.s.].

Salat dhe selam ju qoftë Ehli Bejtit, atyre që Allahu i ka zgjedhur, dashur, që janë të pastër, më të përzgjedhurve në të jashtmen dhe të brendshmen, trashëgimtarëve të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.].

Salat dhe selam ju qoftë as'habëve, atyre që janë lartësuar me shikimin e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.], janë përsosur me muhabetin e tij, që secili prej tyre është ngritur sikur një yll dhe që kanë mbajtur dritën e njerëzimit.

Respekt dhe nderim ju qoftë të gjithë dijetarëve, arifëve dhe robëve të mirë që kanë bartur deri tek ne nurin, fejin, bereqetin dhe ahlakun e bukur, të Pejgamberit të mëshirës që ka ardhur në sipërfaqen e Tokës.

Për familjen e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] janë përdorur emërtime të shumta si: Ehl-i Bejt, Al-i Resul, Al-i

Muhammed, Itretun-Nebi dhe të ngjashme. Ndër këto emërtime, termi më i përdorur është "Ehl-i Bejt".

Fjala Ehl-i Bejt, në gjuhën arabe është term mjaft i gjërë. Kuptimi më i ngushtë është familja e një personi që përfshinë gruan dhe fëmijët, ndërsa kuptimi më i gjërë përfshinë farefisën.

Para Asri-Sadetit [koha e qëndrimit të Hz. Muhamedit [s.a.v.s.] si peygamber në këtë botë], në kohën e xhahilijetit, në shoqërinë arabe termi Ehl-i Bejt, është përdorur për familjen prijëse të fisit. Në Asri-Sadet, me termet "Ehl-i Bejt dhe Al-i Bejt" është kuptuar familja e Hz. Peygamberit [s.a.v.s.]. Prej Asri-Sadetit deri në ditët e sotme, termi Ehl-i Bejt është përvetësuar për të nënkuptuar familjen e Resuli Ekremit [s.a.v.s.]

Ehl-i Bejtin e Resuli Ekremit [s.a.v.s.] e përbëjnë secili familjar që ka jetuar në një shtëpi me të.

Kjo vepër, mbi atë se si dhe pse ta duam Ehl-i Bejtin, çfarë obligime dhe përgjegjësi kemi ndaj tyre, është shkruar në bazë të dijetarëve të Ehl-i sunnet vel xhema't. Zaten, kjo është edhe peshorja për të kuptuar dhe vepruar sipas urdhërave të Allahut Teala. Kjo peshore na mundëson që çdoherë dhe për çdo gjë të marrim vendime të shëndosha dhe të mbesim në rrugën e drejtë, pa shkuar në skajshmëri.

Vet ky punim është një shprehje e dashurisë ndaj tyre.

Të ushqehemi me duatë, dashurinë dhe përkushtimin e tyre...

S. Mubarek Erol

KAPITULLI I PARË

DRITA E SYVE: EHLI BEJTI

Kush janë Ehli Bejt i Hz. Pejgamberit?

Termi "Ehli Bejt" nënkupton të zotin e shtëpisë, gruan e tij, fëmijët, nipat dhe akrobatë [farefisin] e afërm.

Ehli Bejt i Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] përfshinë gratë e tij, fëmijët, nipat dhe mbesat, axhallarët e tij që kanë qenë myslimanë, fëmijët e tyre, nipat e tyre dhe akrobatë tjerë nga Hashimitë dhe Mutalibët. Në ditët tona, fjala Ehli Bejt në përgjithësi nënkupton pasardhësit nga loza e nipave të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.], Hz. Hasanit [r.a.] dhe Hz. Husejnit [r.a.].

Sejjidët dhe Sherifët në ditët tona Ç' do të thotë Sejjid?

Fjala sejjid ka kuptimin **efendi, zotëri, prijës, kryetar**. Mirëpo, ky term përdoret për të gjithë ata

pasardhës që nëpërmjet Hz. Husejnit [r.a.] arrijnë tek Zotëriu i tërë njerëzimit Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.]

Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] ka pasur këto sifate - emërtime: “Sejjidul-Sekalejn” [Zotëriu i të dy botëve], “Sejjidul-Enam” [Më i madhi ndër krijesa], “Sejjidul-Enbija” [Zotëriu i të gjithë Pejgamberëve]. Në një hadithi-sherif thotë:

“Unë jam Sejjidi/ zotëriu i bijëve të Ademit”,¹
ndërsa në një tjetër hadithi-sherif drejtohet:

“Në ditën e kijametit unë jam Sejjidi/ prijësi i njerëzimit.”²

Në hadithe, fjala sejjid është përdorur në këto kuptime: prijësi i fisit, kryesuesi i shoqërisë, të zgjedhurit e shoqërisë, dhe pronari i robërve.

Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] në një rast kur ishte në minber, duke treguar kah Hz. Hasani [r.a.] tha:

“Ky bir imi është sejjid. Mendohet se Allahu për hir të tij do të pajtojë dy grupe myslimanësh”,³
e në një rast tjetër u drejtua:

“Hasani dhe Husejni [r.a.] janë Sejjidët e rinisë së xhenetit.”⁴ Për Hz. Fatimen [r.anha] tha:

“Fatimja [r.anha] është Sejjidja e grave të xhenetit.”⁵ Për Hz. Ebu Bekrin [r.a.] dhe Hz. Omerin [r.a.] tha:

“Prej xhenetlije, përveç nebijve dhe resulëve janë edhe dy sejjidë të moshuar.”⁶

¹ Ebu Davud, Sunen, 13; Ibn Maxhe, Zuhd, 37.

² Buhari, Enbija, 3; Muslim, Iman, 367, 369, Fezail, 2.

³ Buhari, Sulh, 9; Fezailul-As’hab, 22; Tirmidhi, Menakib, 31.

⁴ Tirmidhi, Menakib, 31; Taberani, el-Muxhemul Kebir, nr. 2598.

⁵ Buhari, Fezailul-As’hab, 29; Menakib, 25.

⁶ Ibn Maxhe, Mukaddime, 11.

Në mesin e as'habëve fjala sejjid është përdorur për të lavdëruar dhe vlerësuar. Në një rast, Hz. Omeri [r.a.] tha: *"Ebu Bekri [r.a.] është sejjidi ynë. Sejjidi ynë, e shpëtoi nga robëria Hz. Bilalin [r.a.] dhe i dha lirinë".*⁷

Ç' do të thotë Sherif?

Fjala Sherif, do të thotë: i lartësuar, fisnik, i nderuar, krenar, me nivel dhe pozitë të lartë, i lartësuar dhe në gradë të lartë shpirtërore. Në shumës, merr trajtën eshref dhe shurefa. Në përgjithësi, është përdorur për ata që kanë pasur babë dhe gjyshër të ngritur. Emërtimi sherif, apo në shumës eshref, është përdorur në një shtet apo shoqëri, për ata që ju është dhënë udhëheqja, fisnikëria, pozita e lartë dhe fjala e të cilëve ka pasur ndikim.

Në Islam, fjala sherif nënkupton atë që është i devotshëm, që frikësohet nga Allahu, që largohet nga haramet dhe ndjekë urdhërat e Allahut. Në këtë mënyrë, Allahu Teala na thotë:

"Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. [49-Huxhurat: 13]. Sepse me devotshmëri shpirtërat arrijnë shkallë të larta nderimi e lartësimi.

Deri në kohën e Abasitëve, termet sherif dhe eshref janë përdorur në përgjithësi për Hashimitët dhe pasardhësit e Ebu Talibëve, por posaçërisht për sojin e Hz. Hasanit[r.a.] dhe Hz. Husejnit [r.a.] Pra, i jipet përparësi e posaçme sojit të fëmijëve të Hz. Fatimes [r.anha] sepse lidhet me Resulullahun [s.a.v.s.], për këtë arsye janë quajtur fëmijët dhe nipat e Rusulullahut [s.a.v.s.]. Ndërsa

⁷ Buhari, Fezailul-As'hab, 23.

H. Pejgamberi [s.a.v.s.] si në devotshmëri ashtu edhe në soj është më i larti [sherif] i njerëzimit.

Termi “sherif” është bërë traditë të emërtojë sojin e H. Hasanit [r.a.] qysh nga shekullit II Hixhri. Pra, të gjithë ata që vijnë nga loza e H. Hasanit [r.a.] janë emërtuar “sherif”.

Sejjidët dhe sherifët në histori

Pasi që H. Pejgamberi [s.a.v.s.] ka përdorur termin sejjid për nipat e tij, në hadithi-sherif:

“H. Hasani [r.a.] dhe H. Husejni [r.a.] janë dy Sejjidët e rinisë së xhenetit”,⁸ kjo ka qenë arsyeja pse myslimanët kanë përdorur termin sejjid për ta dhe të gjithë pasardhësit e tyre.

Në fillim, fjala sejjid është përdorur për H. Hasanin [r.a.] dhe H. Husejnin [r.a.] dhe fëmijët e tyre. Por, në kohën e Abasitëve, termi sejjid është përdorur për H. Husejnin [r.a.] dhe pasardhësit të tij. Ndërsa, për H. Hasanin [r.a.] dhe pasardhësit e tij është përdorur termi sherif. Për gjininë femrore: sejjide dhe sherife. Gjithashtu, për sojin e H. Hasanit [r.a.] është përdorur termi “Haseni”, e për sojin e H. Husejnit [r.a.] “Husejni”.

Në përgjithësi, udhëheqësit shtetëror kanë pasur respekt të posaçëm për sejjidët dhe sherifët. Në historinë e të gjitha shteteve islame ka pasur institucion të veçantë për ta, me në krye Nakibul-eshraf, e cila ka qenë një ndër pozitat më të rëndësishme. Ky është një argument i qartë për respektin që iu është kushtuar. Pozita e Nakibul-eshrafit ka qenë menjëherë pas pozitave Muhtelif-enam dhe Shejhul-islam.

⁸ Tirmidhi, Menakib, 31; Taberani, El Muxhemil Kebir, nr. 2598.

Në mesin e sejjidëve ai që ka ditur më së miri lozën e sojit, është përzgjedhur dhe emërtuar si nakib. Nakib ka kuptimin: më i zgjedhuri i shoqërisë, prijësi i shoqërisë dhe ai që përkujdeset për çështje të shoqërisë. Ai është vendosur në qendrën kryesore të shtetit dhe detyrat e tij kanë përfshirë: përkujdesjen për shëndetin e sojit të Hz. Hasanit dhe Hz. Husejnit [radiallahu anhuma], mbikqyrjen, vërtetimin dhe regjistrimin e lindjeve dhe vdekjeve të tyre, ka ndërmjetësuar në mosmarrëveshjet eventuale në mes tyre dhe ka gjykuar nëse dikush ka vepruar në kundërshtim me ligjin.

Në kohën e Harun Rashidit dhe Memunit, sherifët dhe sejjidët kanë veshur xhybe të gjelbërta dhe kanë lidhur në kokë sargi të gjelbërt. Kjo traditë u largua në fund të kohës së Abasitëve. Më vonë, me urdhërin e Melikul-Eshrefit, sunduesit të Memlukëve, në vitin 773 [1371] u kthye bartja e sargisë së gjelbër, apo ndonjë teshe të gjelbër, në mënyrë që sejjidët dhe sherifët të dallohen dhe respektohen nga populli. Më vonë kjo traditë u pranua edhe nga osmanlijtë.

Ehli Bejti në Perandorinë Osmane

Prej themelimit të Perandorisë Osmane është treguar një dashuri dhe respekt i veçantë për sojin e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]. Në këtë mënyrë, për t'iu siguruar atyre një jetë të rehatshme dhe të respektuar, ata nuk janë marrë në ushtri, nuk është marrë asnjë lloj tatimi prej tyre, si dhe nga populli janë konsideruar si të zgjedhur.

Për shkak të nderimit ndaj tyre, pozita e Nakibul-eshrafit ka qenë ndër pozitat më të larta, që iu ka takuar sejjidëve dhe sherifëve më të zgjedhur. Në raste të

festave shtetërore, prijësit më të lartë shtetëror kanë pritur Nakibul-eshrafin.

Gjithashtu, konaku i Nakibul-eshrafit ka qenë institucion shtetëror. Në kohën e Osmanlijeve, pas Nakibul-eshrafit, drejtuesi [âmiri] i sejjidëve dhe sherifëve është emërtuar me emrin "Alemdar".

Ndër veprimet kryesore të Nakibul-eshrafit kanë qenë: prezenca në tubime shtetërore, marrja e "bijatit" të parë dhe prezenca e vazhdueshme në raste të tilla, bërja dua në festat shtetërore, bërja dua në flamurin e shenjtë në raste lufte, këndim të duave, salavateve dhe Kuranit, si dhe dhënia e shpatës Sulltanit të ri.

Nakibul-eshraf ka pasur lidhje të drejtpërdrejt me Sadrazamin, në shkrime dhe ftesa.

Me rënien e Perandorisë Osmane edhe ky institucion mbeti pjesë e historisë.

KAPITULLI I DYTË

AMANETI I HZ. PEJGAMBERIT: EHLI BEJTI

Trashëgimtarët e vërtetë të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]

Trashëgimtarët e vërtetë të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] janë dijetarët e Ehli Bejtit që veprojnë sipas ditorisë. Pasiqë, Pejgamberi i Rahmetit [s.a.v.s.] me nurin e shikimit të tij ka ngritur Ehli Bejtin në shkallën më të lartë. Pa dyshim, nga shikimi dhe bereqeti i tij më së shumti ka përfituar Ehli Bejti. Trashëgimtarët e vërtetë nga Ehli Bejti kanë marrë trashëgiminë nga nuri i shikimit të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]. Pasiqë, të parët e Ehli Bejtit me sytë fizik dhe ato të zemrës, duke shikuar nurin e fytyrës së Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.], kanë tërhequr nurin hyjnor nga zemra e tij. Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] që ka parë bukurinë e Allahut dhe shenjat [ajetet] më të mëdha, me shikimin e tij i ka bartur ato në zemrat e Ehli

Bejtit, duke iu forcuar imanin, shtuar bindjen, hequr dyshimet dhe duke mbushur zemrat e tyre me dashuri. Ata kanë pasur dobi të shumta nga burimi i dijes së Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]. Gjithashtu janë rritur së bashku në shtëpinë e shpalljes. Resulullahu [s.a.v.s.] ka folur me ta me gjuhën fizike dhe atë shpirtërore. Kështu Ehli Bejti janë ngritur si yje që shkëlqejnë në qiellin islam dhe kanë ardhur në gjendje të Diellit ndriçues. Ata çdoherë kanë pasuar sunnetin e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] duke qenë shembull të përsosmërisë njerëzore [kemat]. Ata duke jetuar vet Librin e Allahut dhe sunnetin e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] si shembujt më të bukur i kanë bërë davet të tjerëve. Ata kanë thirrur njerëzit për te Haku, por nuk janë ndarë prej Hakut, për asnjë moment. Ata janë shembujt më të bukur dhe kanë pozitativ më të larta të përshkruara në Kurani Kerim. Kanë qenë të parët në dije, devotshmëri, ahlak, nder, vendosmëri në rrugën e Hakut, për Islam kanë qenë në gjendje të japin jetën, e gjithmonë në ballë kundër padrejtësisë dhe zullumit. Tërë kohën kanë ruajtur fenë islame nga bidatet dhe akiden islame. Janë përpjekur vazhdimisht për principet e larta islame, udhëzimin e njerëzve dhe në këtë rrugë nuk kanë kursyer as jetën.

Dijetarët e Ehli Bejtit në çdo periudhë iu kanë reflektuar njerëzve si pasqyrë bukurinë e jashtme dhe të brendshme të Resuli Ekremit [s.a.v.s.] Për këtë arsye, në Kurani Kerim për Ehli Bejtin thuhet se janë të pastruar dhe ruajtur nga të gjitha të këqijat:

“O Ehli Bejt! [O Familje e Pejgamberit] Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë [gjynahet] dhe t’ju pastrojë plotësisht.”- [33-Ahzabë: 33].

Me këtë ajet, është deklaruar roli i Ehli Bejtit në jetën e umetit islam, ku Allahu i Gjithdijshtëm ka dëshiruar të pastrojë vetëm ata nga çdo lloj papastërtie. Pasiqë Allahu Teala përshkruan sifetet që i dha Ehli Bejtit si: pastërtia dhe ruajtja nga gjynahet, të këqijat, e gabimet, atëherë:

“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.” [49-Huxhurat:13]. Pra, Allahu ka dashur që ata të marrin shembull Hz. Pejgamberin [s.a.v.s.] si në devotshmëri, në pasimin e rrugës së tij, në jetësimin e sunnetit të tij, dhe në davet për mbajtjen në jetë të sunnetit të tij. Pra, siç u tha më lartë, del që ata duke poseduar tharmin e pastër, ahlakun e pastër, duke qenë shembëlltyrë dhe udhërrëfyes, kanë edhe kompetencën më të lartë për davet.

Dy amanetet e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]

Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] për hidajet [udhëzim] dhe istikamet [orientim të drejtë] të umetit të vet, iu ka lënë dy amanete dhe ka porositur të lidhemi fuqishëm për to. Zejd b. Erkam [r.a.] tregon se Resuli i Allahut [s.a.v.s.] ndërmjet Mekes dhe Medines, në vendin e quajtur Hummen, pranë ujit, dha një hutbe. Pas falënderimit, lavdërimeve dhe dhikrit për Allahun, na tha:

“O njerëz! Kini vëmendjen; edhe unë jamë njeri. Ardha e melekut të vdekjes nga Rabi im dhe përgjigja ime ndaj tij, do të më ndajë shumë shpejt nga mesi juaj. Juve ju lë dy amanete të rëndësishme me drejtësi të rëndë.

E para, për t'iu çuar në rrugë të drejtë si udhërrëfyes dhe nur është Kurani, Libri i Allahut. Kapuni fuqishëm për të.”

Me këtë amanet Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] na porositë të shtrëngojmë fuqishëm dhe të lidhemi për Kurani Kerimin.

Pas kësaj vazhdoi:

“Amaneti i dytë është Ehli Bejti im. Silluni me respekt ndaj Ehli Bejtit tim. Ju përkujtoj për hakun e Ehli Bejtit tim, kini frikë Allahun. Ju përkujtoj për hakun e Ehli Bejtit tim, kini frikë Allahun. Ju përkujtoj për hakun e Ehli Bejtit tim, kini frikë Allahun.”⁹

Në këtë hadith, duhet të kemi vëmendje të madhe për të drejtën e Ehli Bejtit, pasiqë është përsëritur tri herë dhe kjo është një shenjë që sikur Kurani Kerimi edhe ata do të mbesin deri në ditën e Kijametit.

Është një e vërtetë se myslimanët e kanë mbajtur këtë amanet që ju ka lënë Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] dhe kanë qenë shumë të përkushtuar ndaj tyre, janë munduar të tregojnë përkushtim, në raste vështirësish kanë treguar vullnet për t'iu ndihmuar dhe kanë ditur t'i mbajnë mbi kokë dijetarët e Ehli Bejtit.

Të dalurit zot dy amaneteve e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]

Ne nuk e kemi parë Hz. Pejgamberin [s.a.v.s.] me sytë e kësaj bote. Por, është e mundshme ta shohim Ehli Bejtin e tij. Sot në botë, Ehli Bejti gjindet në shumë vende. Sikurse Kurani si amanet i parë, do të mbetet deri

⁹ Muslim, Fezailus-Sahabe, 4 (nr. 2408).

në Ditën e Kiametit, ashtu edhe Ehli Bejti do ta ketë këtë vazhdimësi deri në Ditë të Kijametit. Resulullahu [s.a.v.s.] neve si umet i tij, na ka nderuar lartë duke na lënë amanet Ehli Bejtin e tij.

Për shkak se Ehli Bejti na është lënë amanet, ne duhet t'iu ndihmojmë dhe t'i dojmë me zemër. Ashtu si i japim ndihmë dhe dashuri të afërmve dhe akrebave tonë, atyre duhet t'iu japim edhe më shumë. Në lidhje me këtë, Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] na ka porositur në këtë mënyrë:

“Më i mbari nga ju, është ai që është më i mbari për Ehli Bejtin tim pas meje.”¹⁰

Ai që i bën një të mirë Ehli Bejtit, do ta shoh atë të mirë Ditën e Kijametit. Kështu, Hz. Resulullahu [s.a.v.s.] na drejtohet:

“Ditën e Kijametit ai që dëshiron shefatin (ndërmjetësimin) tim, mos ta ndërprejë kujdesin për Ehli Bejtin tim, dhe le t'i gëzojë ata.”¹¹

Në transmetimin e Ibn Umerit, kjo ka qenë fjala e fundit e Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.]:

“Dilni zot Ehli Bejtit tim.”¹²

Sevap i pafund

Sipas tregimit të Abdullah b. Mubarek [rha], ai kishte bërë nijet të shkojë në Haxh dhe kishte përgatitur ushqimin dhe pijen për rrugë. Me tu nisur për rrugë, pau një grua, duke përgatitur një pulë të coftë. U afrua dhe e pyeti për arsyen e atij veprimi. Gruaja i tha të qëndronte larg saj dhe mos ta pyeste. Por me insistimin e Abdullahut, ajo filloi të tregojë për gjendjen e saj:

¹⁰ Hakim, el-Mustedrek, 3/311; Ebu Ja'la, Musnedj, nr. 5924.

¹¹ Hejsemi, Mexhma-u-Zevaid, 9/258.

¹² Muslim, Fezailu-Sahabe, 16, 37.

- Unë jam nga soji i Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] dhe jam e varfër. Fëmijët më qajnë nga uria për tri ditë rresht. Edhe coftinën e kemi të obligueshme ta hamë.

Pas kësaj ngjarjeje, Abdullah b. Mubarek [rha] tregon:

“Menjëherë ia dhashë ushqimin dhe pijen që kisha përgatitur për rrugën në Haxh.

- Si të shkoj në Haxh derisa këta janë të uritur, thash dhe u largova nga aty. Normalisht që nuk shkova në Haxh. Pasiqë u kthyen haxhinjët nga Haxhi, populli erdhi të më urojë Haxhillëkun. Unë thash:

- Çfarë po ndodh? Unë nuk u largova nga vendi im dhe u befasova me urimet e njerëzve. Atë natë pashë në ëndërr Hz. Resulullahun [s.a.v.s.] duke më thënë:

- Pasiqë ti i dhe asaj gruaje dhe i shlirove jetimët e saj nga vështirësitë, Allahu Teala e dërgoi një melek në fytyrën tënde dhe ai bëri Haxhin për ty. Kjo do të vazhdojë deri në Ditën e Kijametit dhe ty do të të shkruhen sevapet.”¹³

“Imani nuk hynë në zemrat e atyre që nuk e dojnë Ehli Bejtin tim.”¹⁴

Qëndrimi ynë ndaj Ehli Bejtit

Asnjë besimtar nuk bën të ketë qëndrim negativ ndaj Ehli Bejtit. Pasiqë Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] për ata që kanë qëndrim negativ ndaj tyre, thotë:

¹³ Ebu Bekir el-Hadrami, Reshefetu-Sadi, f. 255.

¹⁴ Tirmidhi, Menakib, 29.

“Betohem në Emrin e Allahut, se ata që kanë urrejtje ndaj meje dhe Ehli Bejtit tim dhe na zemërojnë, pa dyshim do të hyjnë në xhehenem.”¹⁵

Sipas tregimit të Haris b. Abdulmutalibit [r.a.], në një rast kur Hz. Abasi [r.a.] axha i Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.], ishte i zemëruar, u afrua afër Resulullahut [s.a.v.s.]. Edhe unë isha afër tij, tregon. Resulullahu [s.a.v.s.] e pyeti Hz. Abasin [r.a.]:

- **Pse je i zemëruar?**

- Ja Resulallah! Çfarë kemi ne bijtë e Hashimitëve me Kurejshët? Ata takohen me njëri-tjetrin me buzëqeshje, ndërsa kur dalin para nesh, fytyrat e tyre janë ndryshe, iu përgjigj.

Me të dëgjuar këtë, Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] u zemërua dhe iu skuq fytyra. Pastaj na u drejtua:

- **Betohem në Atë, në dorën e Fuqisë së të cilit është shpirti im, derisa nuk ju dojnë për Allahun dhe Resulin, imani nuk do të hyjë në zemrat e tyre.** E më pas, vazhdoi:

- **O njerëz! Çdokush që shkakton vuajtje axhës tim, më ka shkakuar vuajtje mua. Axha i një njeriu është sikurse babai i tij.”¹⁶**

Shihet qartazi se kush i shkakton vuajtje Ehli Bejtit, i ka shkakuar vuajtje Hz. Fatimes [r.anha], edhe personalisht Resulullahut [s.a.v.s.]. Ai që i shkakton vuajtje Resulullahut [s.a.v.s.], Allahu [xh.sh.] nuk tregon mirëkuptim ndaj tij. Ky qëndrim vlen për të gjithë anëtarët e Ehli Bejtit. Në këtë mënyrë, ne jemi urdhëruar

¹⁵ Hakim, el-Mustedrek, 3/150; Ibn Hibban, Es-Sahih, nr. 6978.

¹⁶ Tirmidhi, Menakib, 28; Ahmed b. Hanbel, el-Musned, 1/207.

ta duam Ehli Bejtin. Kjo është një dhuratë e çmuar edhe për këtë botë edhe për ahiret.

Kështu duhet Ehli Bejti

Në kohën kur babain e kishte halife, Hisham b. Abdulmeliku shkoi në Haxh me një grup nga Shami. E vizituan Qaben, derisa deshi ta puthë Haxherul-Esvedin [Guri i Zi] nuk mundi të afrohej nga tollovia e madhe. Askush nuk i lëshoi rrugën as nuk tregoi kujdes për te. Atëherë bëri një vend për tu ulur pranë ujit Zemzem dhe shikonte njerëzit duke bërë tavaf. Në atë moment i biri i Hz. Husejnit [r.a.], Hz. Ali Zejnelabidini [r.a.] erdhi për të bërë tavaf Qaben. Kur i erdhi rendi të vizitohet Haxherul-Esvedin, nga respekti ndaj tij njerëzit menjëherë e hapën rrugën me qetësi dhe respekt që ai të bëjë zjaretin. Hazreti e bëri zjaretin. Hishami dhe grupi nga Shami e panë këtë. Njëri nga ta, e pyeti Hishamin:

- Kush është ky? Hishami edhe pse e njohu atë, tha:
- Nuk e njoh. U frikësua se mos grupi nga Shami do të drejtoheshin kah ai. Aty ndodhej poeti i quajtur Ferezdak dhe tha:
- Unë e njoh atë. Njëri nga grupi i Shamit, iu drejtua me epitetin e tij:
- O Ebu Firas, kush është ky person? Ferezdaku filloi t'iu dëftojë me këto bejte:

*Ky është njeriu të cilit lugina e Bat'hes ia njuh ecjen,
Qabja e njuh, Hili dhe Haremi e njohin sojin e tij prej
nuri të pastër.*

*Ky vjen nga soji më i mbarë i njerëzimit,
I mbrojtur nga gjynahet, i pastër brenda e jashtë, i
zgjedhur dhe hero i devotshmërisë.*

*Kur e shohin Kurejshët dhe përfaqësuesit e tyre thonë:
Ku gjithë mirësitë dhe nderimet përfundojnë, për te
aty fillojnë.*

*Majat e larta të nderimit të tij nuk arrihen assesi.
Të gjithë muslimanët që janë arabë e joarabë,
E bëjnë zjaretin tek Haxherul-esvedi.
Për shkak të bujarisë së tij, edhe Ruknul-Hatimi dorën
t'ia le nuk do,*

*Nga ndruajtja nuk mund ta shikon në sy,
Sytë mbyllen para tij, kokat ulen prej madhësisë së tij.
Me të folet vetëm kur buzëqeshja duket në fytyrë,
Nuri i hidajetit (udhëzimit) shpërthen nga fytyra e tij.
Sikur dielli që shkëlqen kur çanë pluhurin e errësirës,
Ashtu ai vjen nga rrënjët më fisnike, nami i tij është
madhështor.*

*Plotësisht i pastër, në të gjitha pjesët që gjinden në te,
Sepse ai është pjesë e Resultit të Allahut.
Po se dite kush është ky, është i biri i Fatimes,
Me gjyshin e tij merr fund peygamberllëku.
Allahu e ka nderuar, e pozitën e tij lartë e ka ngritur,
Kështu ka shkruar kalemi qysh në ezel.
Thënia jote "kush është ky", nuk e dëmton fare atë
Ti që nuk e njeh, arabë e joarabë Atë e njohin.
Bujaria e duarve të tij është si rrebesh shiu, çdoku bie
Çdoherë kërkohet prej tij mëshirë, sepse skamja nuk e
frikëson atë,*

*Nuk ka brengë për zemërimin e tij, sepse karakteri i tij
është i butë,*

Atë e zbukurojnë dy gjëra: bukuria e krijimit dhe karakteri i tij.

Ai merr mbi vete barrën e të gjithë atyre që donë t'i ndihmojnë,

Karakteri i tij është i ëmbël, shumë kënaqet kur thotë "po".

Asnjëherë nuk thotë "s'ka" ose "jo"

Përveç kur thotë shehadetin (pos Allahut tjetër ilah "s'ka").

Mirësi ka për çdokënd, çdokuj i arrinë e mira e tij,

Në saje të kësaj është larguar pej tij varfëria, ngushtimi e skamja.

Dashuria ndaj tyre është fetarë, ndërsa mos t'i duash ata del prej fesë.

Afërsia ndaj tyre është shkak i shpëtimit dhe ruajtje nga të këqijat.

Me dashuri ndaj tyre ia del në krye çdo fatkeqësie,

Me bereqetin e dashurisë ndaj tyre arrihen nimetet dhe dhuntitë.

Nëse merr parasysht të devotshmit, Ehli Bejti është prijës i tyre,

Nëse pyetet: "Kush janë më të mbarët e njerëzimit? "Ehli Bejti!" është përgjigja.

Asnjë xhymert nuk mund të arrijë gradën e tyre,

Nuk e arrinë dot lartësinë e tyre, sepse ata janë më fisnikët dhe më xhymertët e tërë popullit.

Ngushtimi, nuk e pakëson xhymertllëkun e tyre,

Ata e kanë zanat xhymertllëkun, patën apo s'patën

Pas përmendjes së Allahut vjen përmendja e tyre,

Në fillim e fund të çdo fjale pas Allahut, ata përmenden.

Tërë njerëzimi bartë në krahë hakun e kësaj familje,

Falënderimin ndaj tyre çdokush e ka borxh.

Kushdo që nje Allahun, i nje edhe të parin, gjyshin e sojin e tij,

Sepse ky umet, në saje të tyre njohi dinin Islam.

Hishami e dëgjoi këtë dhe u zemërua e u shqetësua shumë në Ferezdakun për lavdatat dhe dashurinë e lartë të shprehur ndaj Ehli Bejtit, kështu që e burgosi në vendin e quajtur Afsan, që gjendet në mes të Mekes dhe Medines.

Hz. Zejnelabidini [r.a.] mori vesh për këtë dhe i dërgoi selam me një dhuratë prej 12000 dirhem argjendi dhe tha si me keqardhje:

- Po të kisha, do të kisha dërguar edhe më shumë.

Ferezdaku e mori selamin, por nuk i mori paratë, edhe duke kërkuar falje, tha:

- Atë e dua për hir të Allahut, dhe lavdërimet e mia janë të vërteta. Lavdërimet i thura nga dashuria për Hz. Pejgamberin [s.a.v.s.]. Ndërsa u zemërova ndaj Hishamit për hir të Allahut. Paratë nuk i marrë, kthejani.

Hz. Zejnelabidini [r.a.] prapë i dërgoi selamin me paratë dhe tha:

- Në familjet tona, paraja që na del nga dora, nuk kthehet më; ti merri, e harxhoi në daç për veti në daç për këdo, si të duash. Atëherë, Ferezdaku i pranoi.

Ferezdaku gjatë kohës në burg, me poezi përdhoste Hishamin me sarkazëm, kështu që pas një kohe, Hishami e lëshoi nga burgu.¹⁷

Në çdo periudhë, Ehli Bejti është në të njejtin ahlak, sepse ata vijnë nga i njejtë burim, ushqehen nga e njejtë

¹⁷ Ibn Asakiri, Tarihu Medineti Dimashk, 41/401.

dashuri, bartin të njejtin nur, ndajnë në mes veti të njejtën bukuri. Ata janë muxhize [mrekulli] e rahmetit [mëshirës] të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]. Secila gjendje e tyre është një mrekulli që mahnitë. Njerëzve iu servojnë jetë, zemrat e vdekura i ngjallin me nur hyjnor, feyz, ashk, edep, dashuri, dituri dhe dije të thellë. Ata e shartojnë dashurinë në zemrat e njerëzve që kanë nasib. Ajo që merret nga ata, sado pak të jetë, sjellë dobi të madhe, sepse e pakta e tyre është shumë.

Brenda edep, jashtë edukim

Dihet se për çdo njeri, është i nevojshëm edukimi i brendshëm. Pa kultivim, edhe pema nuk jepë fruta. Por edhe nëse jepë, nuk kanë shije. Gjithashtu, edhe po të jetë dikush sejjid, ka nevojë për një edukator. Sikur në bujqësi, që bujkut i nevojitet një agronom ashtu edhe njeriut për t'u pjekur i duhet një murshid [edukator]. Në esencë, murshidi i parë i Ehli Bejtit është Hz. Resulullahu [s.a.v.s.]. Të parët nga Ehli Bejti kanë trashëguar prej tij edukatën dhe diturinë dhe ky trashëgim në mënyrë zinxhirore ka ardhur deri në ditët tona dhe vazhdon më tutje.

I njohur me epitetin Hazret, Shejh Muhammed Dijaudini [k.s.], * (kuddise sirruhu - iu shenjtëroftë e fshehta), ka qenë nga velitë e mëdhenj. Si çdo murshid, edhe ai ka pasur shumë muridë [muhibë]. Ka pasur edhe muridë që kanë qenë sejjidë. Një ditë, një grup nga sejjidët e Bilvanisit [Turqi] u nisën të shkojnë në vizitë tek ai. Kur mori vesh Hazreti se janë nisur për ta vizituar, u ngrit në këmbë, lidhi duart dhe qëndroi ashtu me edep. Pastaj, iu tha muridëve që ishin pranë tij:

“Këtë respekt e bëj ndaj tyre, për hir të gjyshit të tyre. Por, kur të vijnë para meje, nuk do të ngritem në këmbë dhe nuk do t’i respektojë në këtë mënyrë. Sepse, kjo mund të ndikojë në krenarinë e tyre dhe bëhet pengesë për edukatën dhe irshadin e tyre.”

Dhuntia e Allahut

Të jesh prej Ehli Bejtit, është një e dhënë e Allahut. Kjo nuk fitohet, është dhunti. Nuk fitohet duke bërë vepra, është dhuratë e Allahut. Ebu Lehebi, duke qenë axha i Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] nuk i besoi Resulullahut [s.a.v.s.]. Nuk mori pjesë në rradhët e tij. Për këtë arsye, u privua nga të gjitha bukuritë. Në të njejtën mënyrë, gruaja e Ebu Lehebit, Ummu Xhemilja i shkaktoi vuajtje Resuli Ekremit [s.a.v.s.]. Për t’i shkaktuar vuajtje, vendosi therra në rrugën ku kalonte Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.]. Por Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] shkelte në ato therra sikur në mëndafsh. Ndërsa, njëra ndër vajzat e tyre e quajtur Durre, u bë myslimane. Ajo zgjodhi Allahun dhe Resulin [s.a.v.s.]. Ajo bëri Hixhretin [shpërnguljen] nga Meka në Medine bashkë me myslimanët tjerë. Mirëpo, kur disa nga njerëzit e panë atë, i thanë:

- Hixhreti [shpërngulja] yt nuk do të ketë asnjë dobi. Ti je bija e gruas e cila është dru i zjarrit të xhehenemit.

Vajza ia përcjelli këto fjalë Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] Resulullahu [s.a.v.s.] shumë u zemërua. Pas kësaj, hypi në minberin e mesxhidit dhe na u drejtua me këto fjalë:

“Ç’po ndodhë me disa që me sojin dhe akrebatë e mi po më shkaktojnë hidhërim. Keni kujdes! T’i shkaktohet hidhërim atyre që më përkasin mua ose janë nga akrebatë e mi, më kanë hidhëruar mua. Të më shkaktohet hidhërim mua, është t’i shkaktohet hidhërim Allahut.”¹⁸

“Dashuria ndaj meje dhe urrejtja ndaj Ebu Bekrit dhe Omerit nuk mund të gjenden bashkë në zemrën e besimtarit.” – Hz. Ali [k.v.]

Ne i dojmë ata që i nënshtrohen Allahut dhe Resultit [s.a.v.s.] dhe bëjnë vepra si ne. - Musa Riza [rha.].

¹⁸ Taberani, el-Muxhemul Kebir, 24/259 (nr. 660).

KAPITULLI I TRETË

EHLI BEJTI DHE VLERAT E TYRE TË LARTA

Ehli Bejti është i zgjedhur

I dërguari i Rahmetit [mëshirës] të të gjithë alemeve [botëve], Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] dhe Ehli Bejti i tij, të afërmit, gratë dhe as'habët e tij, janë të zgjedhur. Këtë çështje Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] e ka shpreh në fjalë në këtë mënyrë:

“Allahu Teala nga më fisnikët e njerëzve, Kurejshëve, më zgjodhi mua dhe nga mesi i tyre m’i zgjodhi as’habët më të mirë. Disa nga ta, i zgjodhi si vezirë dhe ndihmës të mi për t’iu treguar njerëzve islamin. E prej tyre, disa i ndau për mua si es’har [gruaja, vjehritë, miqtë, balldëskat, e të afërm tjerë]. Mallkimi i Allahut, melaikeve dhe njerëzve qoftë mbi ata që shajnë, që flasin rëndë

për ta. Allahu Teala në Ditën e Kiametit, farzet e synetet e tyre nuk do t'i pranojë.¹⁹

Një ditë, Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] hypi në Minber dhe pyeti:

- **Kush jam unë?** As'habët, thanë:
- Ti je Resuli i Allahut. Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] iu

tha:

- **Unë jam Muhammedi i biri i Allahit, të birit të Abdul Mutalibit. Kur Allahu Teala krijoi krijesat, mua më zgjodhi si më të mbarin. Pastaj, ndau njerëzit në dy popuj: arabë dhe joarabë. Prej tyre mua më zgjodhi më të mbarin. Pastaj krijoi fiset dhe mua më zgjodhi nga fisi më i mbarë. Pastaj nga Kurejshët, mua më zgjodhi më të mbarin.**²⁰

Transmeton Ibn Sadi nga Abdurrahmani e ai nga babai i tij:

“Ishin mbledhur një grup nga Kurejshët dhe në përkujtim të nimeteve të Allahut Teala lavdëronin veten. Çdonjëri lavdëronte veten. Hz. Muaviu [r.a.] i thotë Hz. Hasanit [r.a.]:

- Pse ti s'po flet? Ti nuk ke asnjë pengesë në të folur. Hz. Hasani [r.a.] i dha këtë përgjigje:

- Në mua gjinden bukuri dhe nimete edhe më të vlefshme se të gjithë atyre që folën dhe u lavdëruan. Atëherë, çfarë nevojë ka të flas e të lavdërohem?”

Abdullah b. Abas [r.a.] thotë: “Ne që jemi nga Ehli Bejti i Resulullahut [s.a.v.s.] jemi degë nga druri i nubuvetit [pejgamberisë]. Neve na vijnë melaiket dhe

¹⁹ Taberani, el-Muxhemul Kebir, 17/140 (nr. 349).

²⁰ Tirmidhi, Menakib, 1 (nr. 3608).

prej neve shkojnë. Ne jemi nga shtëpia e Librit hyjnor, shtëpia e Rahmetit dhe burimit të diturisë.”²¹

H. Hasani [r.a.] u drejtohej banorëve të Kufes, me këto shprehje shumë të rëndësishme:

“O njerëz! Mua më njihni, por nëse ka nga mesi juaj dikush që nuk më njeh, unë jam Hasani, i biri i përkujtuesit të lajmeve të mira dhe thirrjes në Islam Muhammed Resulullahut [s.a.v.s.]. Unë jam nga Ehli Bejti, e Allahu ata i ka larguar nga çdo e metë dhe i ka bërë të panjollë. Prapë, në Kuran tregohet në ajet:

“Kush bën ndonjë të mirë, Ne ia shumëfishojmë të mirat .” [42-Shura: 23], unë jam nga Ehli Bejti që Allahu Teala e ka bërë obligim ta duam me këtë ajet. Ky ajet, me fjalën “të mirë”, nënkupton të mirën që i bëhet Ehli Bejtit.”²²

Më i ngrituri i çdo drejtimi

Një ditë në një mexhlis ku ndodheshin Kurejshit dhe prijësit e të tjerëve, H. Muavia [r.a.] pyeti njerëzit:

- Kush është më i ngrituri në mesin e njerëzve nga baba, nëna, axha, halla, daja, tezja, gjyshi, e gjyshja? Malik b. Axhlen [r.a.] u ngrit dhe tregoi me gisht kah H. Hasani [r.a.] që ndodhej në atë mexhlis dhe tha:

- Babai i tij është Ali b. Ebu Talib [r.a.], nëna e tij është H. Fatimja [r.anha] e bija e Resulullahut [s.a.v.s.], gjyshja e tij është H. Hatixhja [r.anha], gjyshi i tij është H. Muhammedi [s.a.v.s.], axha i tij është H. Xhafer-i Tajari [r.a.], halla e tij është Ummu Hani [r.anha], dajët dhe tezet e tij janë fëmijët e H. Pejgamberit [s.a.v.s.].

²¹ Ibn Maxhe el-Hejtemi, Fezailu Ali-Resul, f. 185.

²² Hejsemi, Mexhma-u-Zevaid, 9/146

- Një heshtje e kaploi mexhlisin dhe askush nuk lëshoi asnjë zë. Njëri nga fisi Sehm u ngrit dhe e pyeti Hz. Hasanin [r.a.]:

- Mos e urdhërove ti Ibn Axhlenin [r.a.] të flas në këtë mënyrë? Ibn Axhleni [r.a.] u përgjigj:

- Unë fola vetëm të vërtetën. Pos atyre që janë vulosur me mallkim, asnjë njeri nuk mund ta fitojë kënaqësinë e njerëzve duke qenë kryeneç ndaj Allahut. Dijeni mirë se prej Hashimive vie aroma më e bukur dhe ata e kanë kyçin e dorës më të fortin. O Muavi, a nuk është kjo e vërtetë? E pyeti. Pastaj, Hz. Muaviu [r.a.] tha:

- Po. Vallahi, ashtu është.²³

A është Ehli Bejti pa gjynahe?

Sipas besimit të Ehli sunnetit, vetëm peygamberët janë pa gjynahe. Ehli Bejti nuk janë pa gjynahe. Mirëpo, shi'itë besojnë se ata që janë nga Ehli Bejti janë të ruajtur nga gjynahet. Sipas shi'ive, Ehli Bejti janë të ruajtur dhe plotësisht të pastër nga çdo gabim apo mangësi në besim dhe vepra. Dijetarët e Ehli-Sunnetit, si në çdo çështje tjetër, kanë qëndruar larg nga skajshmëritë dhe kanë një qëndrim të pranueshëm dhe të shkurt për Ehli Bejtin: ardhja e Ehli Bejtit nga Hz. Peygamberi [s.a.v.s.] sigurisht që është një nder i madh. Por, ky nder i madh nuk i bënë ata të ruajtur nga gjynahet, që d.m.th. se ata nuk janë masum/ pa gjynahe. Sepse sifati "ismet" u takon vetëm peygamberëve.

Mund të ndodhë që sejjidët dhe sherifët të bëjnë ndonjë gjynah. Por kjo nuk bëhet shkak që ata të dalin

²³ Taberani, el-Muxhemil Kebir, nr. 2682.

nga Ehli Bejti. Në lidhje me këtë Ibn Haxher Hejtemi thotë:

“Nëse dikush nga soji që lidhet me shtëpinë e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.], bën ndonjë gjynah apo nuk është fetar, ai nuk përjashtohet nga Ehli Bejti.”

Në esencë, shembulli i një njeriu që bën zina [imoralitet], që pin, vjedhë, e pastaj denohet dhe e vuan denimin, i përngjanë shembullit të sherifit që përlyen këmbët në flliqësi e pastaj shërbëtorët e vet ia pastrojnë. Prandaj, duhet të kemi kujdes të madh ndaj tyre. Edhe fëmija i padëgjueshëm nuk përjashtohet nga trashëgimia. Por, Allahu na ruajt, po të bie në kufër [mosbesim] ndonjëri prej tyre, atëherë lidhja me Resulullahun [s.a.v.s.] këputet. Por, absolutisht nuk besoj se dikush që konsiderohet si pjesë/copë e Resulullahut [s.a.v.s.] mund të bie në kufër [mosbesim]. Deri më tani, nuk është parë dikush nga ta të ketë bërë zina [imoralitet], apo gjynah të ngjashëm. Pasiqë kështu është gjendja, atëherë si mund të bien në kufër [mosbesim]?”²⁴

Për këtë arsye, ne nuk bën të hidhërohemi me sejjidët, por mund të hidhërohemi me veprat e tyre. Nëse shohim dikë nga Ehli Bejti duke bërë një vepër që nuk i takon atyre, ne duhet t’ia tërheqim vërejtjen [këshillojmë] me një gjuhë të mirë. Pra, atyre mund t’ua tërheqim vërejtjen për gabime, por jo ta përgojmë personalitetin e tyre.

Në lidhje me këtë çështje, Gavsi i Hizanit, Sejjid Sibgatullah Arvasi [k.s.] ka thënë:

“Nëse dikush nga sejjidët apo sherifët është shi’i apo bidatçi, ne hidhërohemi në vetitë e tij e jo në

²⁴ Ibn Haxher el-Hejtemi, el-Fetaval-Hadisije, f. 166.

personalitetin e tij. E njehta vlenë edhe për sejjidët që mohojnë.”²⁵

Por Allahu Teala atyre u ka bërë dhuratë, i ka zgjedhur, e në mesin e myslimanëve i ka bërë shkak për të fituar dhurata. Zjarri i xhehenemit është bërë haram për Ehli Bejtin. Këtë e kuptojmë nga hadithi-sherif i Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]:**“Allahu e ka bërë haram xhehennemin për Fatimen dhe sojin e saj.”**²⁶

Vlerat e larta [fazileti] të Ehli Bejtit

Sipas rrëfimit të nënës sonë, Ummu Selemes [r.anha], Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] iu drejtua të bijës, Hz. Fatimes [r.anha]:

- **M'i sjell afër burrin dhe fëmijët tu.** Ajo shkoi dhe i solli. Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] e vendosi mbi ta xhyben që kishte sjellur nga Fedeku dhe i vendosi duart e tij të bekuara mbi ta, dhe tha:

- **Allahu im, këta janë familja e Muhammedit, siç i zbritte rahmet [mëshirë] dhe bereqete sojit të Ibrahimit, ashtu zbriti edhe familjes së Muhammedit. Pa dyshim, Ti je i Lartë, i Lavdëruar.”** Ummu Selemeja [r.anha] tha:

- Edhe unë desha të hyj nën atë xhybe dhe t'iu bashkangjitem atyre. Kështu, ngrita një kënd të xhybes. Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] tërheku xhyben nga dora ime dhe nuk më lejoi të futem nën xhybe. Më tha:

“Ti je sipër mbarësisë dhe lumturisë.”²⁷

Në tregimin e Hz. Aishes [r.anha], Resuli Ekremi [s.a.v.s.] doli nga shtëpia në mëngjes, i veshur me një

²⁵ Sejid Sibgatullah el-Arvasi, Minah, 85, Minha

²⁶ Taberani, el-Muxhemul Kebir, nr. 11685.

²⁷ Sujuti, Edurrul-Mensur, 6/604.

gunë prej leshi të zi, të çëndisur. Në atë moment erdhi Hasani [r.a.] dhe e futi nën gunë. Pastaj erdhi Husejni [r.a.] edhe atë e futi nën gunë. Pastaj erdhi Fatimja [r.anha] e ai edhe atë e mori nën mbulojë. Më vonë edhe Aliu [r.a.] erdhi, edhe atë e mbuloi me gunë. Pastaj këndoi ajetin:

“O Ehli Bejt! Në të vërtetë, Allahu do që të largojë prej jush gjynahet dhe t’ju pastrojë plotësisht.” [33-Ahzab: 33].²⁸

Transmeton Enes b. Malik [r.a.] :

Pasi zbriti ajeti: **“O Ehli Bejt! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush gjynahet dhe t’ju pastrojë plotësisht.”** [33-Ahzabë: 33], Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] duke shkuar në namazin e sabahut, për një periudhë afër gjashtë mujore drejtohej në derën e Hz. Fatimes [radijallahu anha.]:

“O Ehli Bejt! Zgjohuni për namaz, Allahu dëshiron t’iu pastrojë plotësisht nga gjynahet.”²⁹

Ehli Bejti është sikur anija e Nuhut

I dërguari mëshirë për të gjithë botët, Oqeani i Rahmetit, Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] për çdokënd ka qenë rahmet [mëshirë] dhe siguri. Kështu që Allahu Teala, thotë në ajet:

“Po Allahu nuk do t’iu japë vuajtje atyre, derisa ti [Muhammed] je në mesin e tyre dhe Allahu nuk do t’iu japë vuajtje derisa ata kërkojnë falje [istigfarë].” (8-Enfal: 33).

²⁸ Muslim, Fezailu-Sahabe, 9 (nr. 61).

²⁹ Tirmidhi, Tefsir, nr. 3206; Ahmed b. Hanbel, el-Musned, 3/259, 285.

Në këtë ajet shihet që derisa Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] gjendet në mesin e tyre dhe bëjnë teube-istigfarë [pendohen] për veprat e këqija, Allahu nuk do t'i japë vuajtje.

Sipas dijetarëve edhe prezenca e Ehli Bejtit është një shkak i sigurisë. Prezenca e Ehli Bejtit është siguri dhe mbrojtje për njerëzimin, e në veçanti për umetin e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.].

Pra sa i përket sigurisë, Ehli Bejti qëndron në vend të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]. Sepse ata bartin një pjesë të nurit të Resulullahut [s.a.v.s.].

Kështu që, kush i bën nder dhe respekt Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] dhe Ehli Bejtit të tij, Allahu nuk iu jepë vuajtje.

Ebu Dherri [r.a.] thotë: e dëgjova Resulullahun [s.a.v.s.] kur tha kështu:

“Pranoni Ehli Bejtin tim sikur kokën në trup, e sikur sytë në kokë.”³⁰

Në një hadith tjetër Resulullahu [s.a.v.s.] na thotë:

“Yjet janë siguria e qiellit. Ehli Bejti im është siguria e umetit tim.”³¹ Në një transmetim tjetër,

“Ehli Bejti im është siguri për ata që gjenden mbi sipërfaqe të Tokës. Nëse Ehli Bejti im zhduket, atëherë atyre që gjenden në sipërfaqe të Tokës, do të fillojë t’iu vije ajo që është premtuar.”³²

Sipas transmetimit të Ahmed b. Hanbelit [r.a.] është thënë:

“Nëse yjet zhduken edhe qielli zhduket, por nëse Ehli Bejti zhduket, edhe njerëzit mbi sipërfaqe të tokës zhduken.”³³

³⁰ Taberani, El-Muxhemul Kebir. Nr. 2640.

³¹ Taberani, El-Muxhemul Kebir. Nr. 6260.

³² Hakim, el-Mustedrek, 2/448; Axhluni, Keshfu'l-Hafa, 2/294[nr.2855]

³³ Dejlemi, Fireusul-Ahbar, nr. 7166.

Prapë Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] ka krahasuar Ehli Bejtin me anijen e Nuhut [a.s.] duke thënë: **“Ehli Bejti ëshë sikur anija e Nuhut. Kush hypë në te shpëton, e kush mbetet jashtë përmytet.”**³⁴

Lëkura që duhet puthur

Një ditë Imam Azami [r.a.], kishte ardhur tek hoxha i tij Hz. Imam Xhafer Sadiku [r.a.] për të dëgjuar dije dhe hadith. Hoxha i tij me bastun në dorë i doli para. Imam Azami [r.a.] i tha:

- O evladi [i biri] i Resulullahut [s.a.v.s.] ju ende nuk jeni në atë moshë që te iu duhet bastuni. Hz. Xhafer Sadiku [r.a.] tha:


- Ashtu është si thua, por ky bastun është i Hz. Resulullahut [s.a.v.s.], e mbajë për bereqet. Imami Azam [r.a.] menjëherë e përqafoi bastunin dhe tha:

- O evladi [i biri] i Resulullahut [s.a.v.s.] më lejo ta puthi bastunin. Hz. Xhafer Sadiku [r.a.] hapi krahun dhe duke i treguar Imam Azamit [r.a.] i tha:

- Vallahi ti e di që kjo lëkurë bartë qelizat e trupit të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] dhe këto qime që sheh janë nga qimet e tij. Ato nuk do t'i puthësh, ndërsa do ta puthësh bastunin. Me këtë, e përkujtoi që Hz. Hasani [r.a.] dhe Hz. Husejni [r.a.] janë edhe trashëgimtarë biologjik të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.].³⁵

³⁴ Hakim, el-Mustedrek, 3/151; Ahmed b. Hanbel, el-Musned, 3/157.

³⁵ Shih, Muhamed Besjuni, e-Sejide Fatimatu-Zehra, f. 37.



KAPITULLI I KATËRT

SIGURIA NË DASHURINË NDAJ EHLI BEJTIT

Siguria në dashurinë ndaj Ehli Bejtit

Pas dashurisë ndaj Allahut [xh.sh.] dashuria më e vlefshme është ndaj Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]. Dashuria ndaj Allahut [xh.sh.] është t'i duam ata që i ka dashur Ai. Pa dyshim që Haku Teala më së shumti ka dashur Resulin e Tij Hz. Muhammed Mustafanë [s.a.v.s.] e më të dashurit e Hz. Muhammedit [s.a.v.s.] janë Ehli Bejti i tij dhe as'habët e tij. Ai që do Allahun [xh.sh.] sigurisht që i do edhe ata që Ai i do. Shenjë që muhabeti dhe dashuria ndaj të dashurit është e plotë dhe e pjekur, është dashuria ndaj tyre dhe të afërmeve të tyre. Vërtetë kjo është e domosdoshme për të pasur dashuri të vërtetë. Për këtë arsye çdo mumin [besimtar], siç e do Hz. Pejgamberin [s.a.v.s.] duhet ta dojë edhe Ehli Bejtin e tij.

Respekti dhe nderimi i lartë për Ehli Bejtin e pastër të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.], akrebatë [të afërmit] e tij, të

zgjedhurit nga soji i tij, nënkupton respekt dhe nderim i lartë për Hz. Pejgamberin [s.a.v.s.]. Rëndësia e dashurisë ndaj Ehli Bejtit përmendet në shumë hadithe. Resuli Ekrem [s.a.v.s.] nga transmetimi i Ibn Abasit [r.a.] për ta dashur atë e bën të domosdoshme dashurinë ndaj Ehli Bejtit. Sipas tregimit të Ibn Abasit [r.a.] Resulullahu [s.a.v.s.] na thotë kështu:

“Duajeni Allahun për nimetet që iu ka dhënë. Edhe mua më duani për hir të dashurisë ndaj Allahut. Edhe Ehli Bejtin tim duajeni për hir të dashurisë ndaj meje.”³⁶

Ai që e do Resulullahun [s.a.v.s.], i do ata që i ka dashur ai dhe ata që ka urdhëruar të duhen. Edhe Ehli Bejti është prej tyre. Sepse Resuli Ekrem [s.a.v.s.] ka dashur Ehli Bejtin dhe na ka urdhëruar ta dojmë. Për këtë arsye, është e domosdoshme për çdo mumin ta dojë Ehli Bejtin. Një hadithi-sherif, na thotë:

“Kush e do Allahun, e do Kuranin. Kush e do Kuranin më do mua. Kush më do mua i do edhe as’habët dhe akrebatë [të afërmit/ farefisin] e mi.”³⁷

Shumë haptas dhe qartë, na dëftohet në Kurani Kerim që dashuria ndaj Allahut dhe fitimi i kënaqësisë së Tij, arrihet vetëm duke iu nënshtuar Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] kështu Haku Teala thotë:

“Thuaj: Nëse e doni Allahun atëherë ejani pas meje që Allahu t’ju dojë, t’ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është që falë shumë, mëshiron shumë.” [3-Ali Imran: 31].

³⁶ Tirmidhi, Menakib, 32; Hakim, el-Mustedrek, 3/150.

³⁷ Tirmidhi, Menakib, 31.

Në një transmetim të Ibn Abasit [r.a.], Resulullahu [s.a.v.s.] na thotë:

“Robi nuk kalon Rabbin e tij pa dhënë llogari për këto katër gjëra:

- 1. Ku e harxhoi jetën,**
- 2. Ku e kalbi trupin,**
- 3. Ku e harxhoi mallin e fituar,**
- 4. Dashurinë ndaj Ehli Bejtit.”³⁸**

Dashuria ndaj Ehli Bejtit është farz

Dijetarët islamë kanë nxjerrë përfundimin se dashuria ndaj Ehli Bejtit është farz për çdo mumin [besimtar]. Është detyrë e çdo myslimani, posaqërisht ata që ndjekin vijën e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.], sunnetin e tij, t'i bëjnë respekt të lartë Ehli Bejtit. Pra, dashuria ndaj Ehli Bejtit është urdhër i Allahut. Siç ka bërë farz [obliguar] Allahu Teala për muminët [besimtarët] dashurinë ndaj Resulullahut [s.a.v.s.], ashtu edhe dashuria ndaj pjesëve të tij dhe të afërmëve të tij që i kanë besuar atij, janë për ta gëzuar Hz. Pejgamberin [s.a.v.s.]. Për këtë, në Kuran thuhet kështu:

“[O Resuli im] Thuaj: “Unë nuk kërkojë prej jush ndonjë shpërblim për thirrjen time vetëm se respektin e dashurisë për hir të fafesisë [akreballëkut]”. Kush bën ndonjë të mirë, Ne ia shumëfishojmë të mirat; vërtetë, Allahu falë mëkatet, është mirënjohës.” [42-Shura: 23]

³⁸ Taberani, el-Muxhemul Kebir, nr. 11177.

Komentuesi i madh i Kuranit Imam Fahredin Razi [rha.], në tefsirin e këtij ajeti kerim thotë:

“Ky ajet na tregon se dashuria ndaj Ehli Bejtit dhe as’habëve të Resulullahut [s.a.v.s.] është farz”. Resulullahu [s.a.v.s.] në një hadith sahih na thotë:

“Fatimja është pjesë e imja; kush e hidhëron atë, më ka hidhëruar mua”³⁹ cekë edhe dashurinë ndaj Hz. Aliut [r.a.], Hz. Hasanit [r.a.] dhe Hz. Husejnit [r.a.]. Atë që e ka dashur Resulullahu [s.a.v.s.] është obligim ta dojë edhe tërë umeti i tij. Pastaj, është urdhër për tërë umetin që në fund të çdo namazi të këndohet salat dhe selam për Ehli Bejtin e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]. Kjo është një makam [pozitë] e lartë; kjo nuk i është dhënë askuj tjetër. Gjithë këto tregojnë se dashuria ndaj Ehli Bejtit të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] është farz.”⁴⁰

Vlera e veçantë e dashurisë ndaj Ehli Bejtit

Identiteti i Ehli Bejtit është dashuria ndaj Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.], besimi ndaj tij, pasimi i rrugës së tij që është një nur që nuk shuhet, fazilet i paskajshëm dhe burim i muhabetit [dashurisë]. Duke filluar prej kohës kur shpallja hyjnore ka përmendur këtë emër të bekuar, myslimanët me t’u njoftuar me këtë emër të lavdëruar, kanë treguar lidhje dhe dashuri ndaj tij. Dashuria dhe kujdesi ndaj tyre mund të haset në shumë burime të hadithit. Resulullahu [s.a.v.s.] duke iu drejtuar Hz. Aliut [r.a.] thotë:

³⁹ Buhari, Fezailul As’habin-Nebi, 12.

⁴⁰ Shih Razi, Mefatihul-Gajb, 9/595.

“Ja Ali, ty të duan vetëm ata që janë muminë (besimtarë), e të urrejnë vetëm ata që janë munafikë [dyfytirësh].”⁴¹

Resuli i Allahut [s.a.v.s.] për Hz. Hasanin [r.a.] dhe Hz. Husejnin [r.a.] ka bërë dua.

“Këta janë evladë të mi, fëmijët e evladit tim. Allahu im, unë i dua ata, edhe Ti duaji. Allahu im, edhe ata që i duan, duaji!”⁴² në një hadith tjetër na thotë kështu:

“Rabi im më ka premtuar se nga mesi i Ehli Bejtit, kush qëndron në tevhidin [njëshmërinë] e Allahut dhe më pranon mua si Pejgamber, atij nuk do t’i shkaktojë vuajtje.”⁴³

Sipas tregimit të Ebu Hurejres [r.a.], Resulullahu [s.a.v.s.] kështu është drejtuar për Hz. Hasanin [r.a.]

“Allahu im, unë e dua atë dhe ata që e dojnë atë.”⁴⁴

Ebu Hurejre [r.a.] thotë: “Kur e dëgjova këtë nga Resulullahu [s.a.v.s.] askush nuk ishte më i dashur për mua se Hasani.” Prapë thotë:

“Sa herë që kam parë Hasan b. Ali [r.a.] sytë mu kanë mbushur me lotë. Arsyeja është kjo ndodhi: Një ditë rrinim në xhami bashkë me Hz. Pejgamberin [s.a.v.s.] Resulullahu [s.a.v.s.] më kapi për dore dhe dolëm nga xhamia. Pastaj u mbështet për mua derisa arritëm te çarshia Kajnuka. Pasi shikoi përreth u kthyem prapa në mesxhid dhe u ul. Pastaj tha:

⁴¹ Muslim, Iman, 131; Tirmidhi, Menakib, 20; Nesai, Iman, 19.

⁴² Tirmidhi, Menakib, 50.

⁴³ Hakim, el-Mustedrek, 3/150.

⁴⁴ Ibn Asakir, Tarihu Medineti Dimashk, 13/193.

- **Ma sjell të birin.**

Hz. Hasani [r.a.] erdhi duke vrapuar dhe u ul në prehër të tij. Resulullahu [s.a.v.s.] ia hapi gojën, i futi gjuhën dhe thoshte:

- **Allahu im, unë e dua atë dhe ata që e dojnë atë.**

Këtë e përsëriti tri herë.⁴⁵

Shpërblimi për dashurinë ndaj Ehli Bejtit

Sipas një transmetimi, Hz. Zejnelabidini [r.a.] u sëmur. Një grup njerëzish kishin ardhur për ta vizituar. Hz. Zejnelabidini [r.a.] i pyeti:

- Pse erdhët këtu? Vizitorët ia kthyen:
- Erdhëm sepse të duam. Hz. Zejnelabidini [r.a.] i pyeti:

- Pse na doni neve? Të pranishmit thanë:

- Juve, për shkak se jeni nip i Resulullahut [s.a.v.s.], të duam për hir të Allahut [xh.sh.] dhe Resulit [s.a.v.s.] Në këtë, Zejnelabidini [r.a.] tha:

- Kush na do neve për Allahun [xh.sh.] dhe Resulin [s.a.v.s.] edhe Allahu [xh.sh.] në Ditën e Kijametit do t'i mbanë nën hijen e Arshit. Në atë ditë, pos kësaj hije, s'do të ketë hije tjetër. Atyre që na dojnë, Allahu Teala shpërblimin do t'iu jep në xhenet. Por ata që na duan vetëm për këtë botë, Allahu edhe atyre do t'iu japë rizk [begati] të shumtë.

⁴⁵ Ibn Asakir, Tarihu Medineti Dimashk, 13/193; Kurtubi, el-Xhami li Ahkemil-Kuran, 8/22.

H. Pejgamberi [s.a.v.s.] na drejtohet duke thënë:

“Kush vdes duke dashur familjen e Muhammedit [s.a.v.s.], vdes si shehid. Kush vdes duke dashur familjen e Muhammedit, melaiket e të Madhit Allah dhe rahmeti [mëshira] bëhen vizitorë të varrit të tij. Kush ka urrejtje për familjen e Muhammedit dhe vdes, do të vie në ditën e Kijametit e në mes dy syve të ballit do të ketë të shkruar që shpresa për mëshirën e Allahut i është këputur. Kush ka urrejtje për familjen e Muhammedit dhe vdes, nuk do ta ndjejë as erën e xhenetit. Kush nuk e do Al-i Bejtin tim dhe vdes, nuk do t'i takojë asgjë nga shefati im.”⁴⁶

“Duajeni Ehli Bejtin e Resulullahut [s.a.v.s.] duke pasur kujdes për kënaqësinë dhe hatrin e Resulullahut [s.a.v.s.]” - H. Ebu Bekri [r.a.].

**Dashuria ndaj Ehli Bejtit –
shenjë e imanit dhe shkak
i shkuarjes me iman**

Mungesa e dashurisë ndaj Ehli Bejtit është mangësi në iman. Sepse kjo çështje përmendet në shumë hadithe. Kështu, H. Pejgamberi [s.a.v.s.] na drejtohet:

“Imani nuk hyn në zemrën e atij që nuk e do Ehli Bejtin tim.”⁴⁷

Dashuria ndaj Ehli Bejtit në frymën e fundit, është marrë si kusht për shkuarjen me iman. Kështu, dijetarët e Ehli sunnetit kanë thënë: “Dashuria ndaj Ehli Bejtit bëhet

⁴⁶ Kurtubi, el-Xhami li-Ahkemil Kuran, 8/22.

⁴⁷ Shih Tirmidhi, Menakib, 29 (nr. 3758).

shkak për shkuarjen me iman dhe gjetjen e shpëtimit në frymën e fundit”. Sepse temeli dhe shenja më e fuqishme e imanit është dashuria ndaj Allahut Teala dhe mosdashja e asaj që Allahu nuk e do”.

Hz. Imam Rabani [k.s.] rrëfen lidhur me këtë:

“Babai im ka qenë dijetar i madh në dituri të jashtme dhe të brendshme [zahir dhe batin]. Çdoherë ka këshilluar dhe inkurajuar dashurinë ndaj Ehli Bejtit. Thoshte: Dashuria ndaj Ehli Bejtit luan rol të rëndësishëm që në frymën e fundit të gjejmë shpëtimin e imanit. Për këtë, thoshte se kësaj pune duhet kushtuar shumë rëndësi.

Isha afër kokës tij, gjersa ishte në shtratin e vdekjes. Sado e vogël, prapë kishte vetëdije. Në atë kohë, i përkujtova fjalët e tij për Ehli Bejtin dhe pyeta se si ndikonte ajo dashuri në ato momente. Duke qenë në atë gjendje, më tha: “Unë jam i zhytur tërësisht në oqeanin e dashurisë së Ehli Bejtit e tani po i jap falënderime këtij nimeti.”⁴⁸

Prej dijetarëve të mëdhenj si Hz. Abdurahman Tahî [k.s.] para se të vdiste në agimin e natës së fundit, Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] iu paraqit haptas dhe i urdhëroi të hante mjaltë dhe të pinte sherbet.

Pas këtyre fjalëve, e pyetën:

- A ju shkoi në mendje ndonjë udhëtim? Hz. Tahî [k.s.] tha:

- Po, më kaloi! Dhe shtoi:

- Mos të më kishte shkuar në mendje udhëtimi, Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] nuk do të më paraqitej haptas.

Në atë ditë, në kohën e ikindisë, iu afrua bashkëshortja e tij Sejjide Kadrije Hanëmi, të cilën e tërheqi për fustani dhe i recitoi këto bejte:

⁴⁸ Imam Rabani, Mektubat, Letra 349.

*“Në Haremin e Haremit të Qabes nuk arrinë
Po s’u ngjite për fustanin e evladit të Alisë.”*

Nga fytyra e tij u kuptua qartë që këto bejte i tha si lutje për shefat [ndërmjetësim].⁴⁹

I biri i Hz. Aliut [r.a.], Muhammed b. Hanefije [r.a.] ka thënë:

“Një njeri që i do sejjidët dhe dijetarët edhe shumë gjynahe po të ketë, Allahu Teala i bën shumë dhurata.”

Arifi i madh Hz. Muhjidin ibn Arabi [k.s.] ka thënë:

“Resuli i Allahut [s.a.v.s.] me urdhër të Allahut [xh.sh.] ka dashur që ne t’i duam të afërmit e tij. Pra, një mumin [besimtar] që këtë kërkesë e refuzon, me çfarë fytyre nesër në Ditën e Kijametit do t’i del përpara dhe të shpresojë për shefat? Një ashik i vërtetë ka thënë:

Çdo vepër e dashurisë është e dashur.

Nëse dashuria jote është vërtetë për Allahun [xh.sh.] dhe Resulin [s.a.v.s.], atëherë e don edhe Ehli Bejtin e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] Imani i secilit matet me dashurinë ndaj tyre.⁵⁰

“Yjet janë siguria e qiellit. Ehli Bejti im është siguria e umetit tim.”⁵¹

Matja e dashurisë ndaj Ehli Bejtit

Për arsyet dhe mënyrën e dashurisë ndaj Ehli Bejtit mësojmë nga sunneti i Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] dhe vlerësimet e dijetarëve islamë. Kjo është masa e vërtetë matëse për të kuptuar dhe vepruar drejtë me urdhërat

⁴⁹ Abdurahman Tahi, Isharetler, f. 21.

⁵⁰ Ibnu-l Arabi, el-Futuhatul Mekkiye, 1/29 (përmbajtja kyçe).

⁵¹ Taberani, el-Muxhemul Kebir, nr. 6260.

hyjnore. Kur meret kjo masë, largohemi nga skajshmëritë dhe na mundësohet që çdoherë të vijmë në përfundime të shëndosha.

Në dashurinë ndaj Ehli Bejtit, kohë pas kohe njerëzit duke shkuar në dy skajshmëri, kanë ardhur në përfundime të gabueshme. Një grup njerëzish, në emër të lidhjes dhe dashurisë për Ehli Bejtin janë armiqësuar në disa as'habë, kanë shpikur shpifje ndaj tyre e kështu kanë rënë në gabim dhe kanë hyrë në rrugë pa dalje. Ndërsa, disa të tjerë, që është dashur të tregojnë respekt për Ehli Bejtin, nuk e kanë treguar këtë dhe ndonjëherë kanë shkuar shumë larg në shpifje dhe urrejtje ndaj atij soji të pastër.

Çdoherë, si në lidhje me këtë çështje ashtu edhe për çdo çështje tjetër të rëndësishme, janë botëkuptimet e Ehli sunnet vel xhematit ato që pasojnë Kuranin dhe sunnetin, që na tregojnë rrugën më të drejtë dhe rrugën e mesme.

Padyshim që çdo mysliman duhet dashur Resulullahun [s.a.v.s.], as'habët e tij, gratë e tij që janë nënat tona, fëmijët e tij, vjehrit e tij dhe dhënduert e tij. Njëri të mos duhet nga këta, nuk është e vërtetë dashuria e tij ndaj Resulullahut [s.a.v.s.]. Siç gabojnë të krishterët që thonë se e duan Hz. Isanë [a.s.] dhe e mohojnë Hz. Muhammedin [s.a.v.s.], ashtu është gabim të thuhet se e duam Hz. Alinë [r.a.] por i urrejmë as'habët tjerë.

Për dallim nga qëndrimi i skajshëm i Rafidive dhe Harixhive ndaj dashurisë së Hz. Alisë [r.a.] dhe Ehli Bejtit, qëndrimi i Ehli sunnetit është i mesëm. Kështu, Harixhitë patën qëndrim armiqësor ndaj Hz. Alisë [r.a.], ndërsa Rafiditë në dashurinë ndaj Hz. Alisë [r.a.] shkuan larg duke urreyer as'habët [shokët] më të mëdhenj dhe më të

afërt të Resulullahut [s.a.v.s.] Një grup prej tyre shkuan edhe më larg duke ia veshur Hz. Alisë [r.a.] ilah-llëk [që është ilah].

Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] duke iu drejtuar Hz. Alisë [r.a.] kështu e përshkruajti në fjalë këtë çështje:

“Ja Ali! Shoh tek ti ngjashmëri me Isanë. Jahuditë u bënë armiq të tij dhe shpifën për nënën e tij. Të krishterët shkuan larg në dashurinë ndaj tij. E ngritën edhe më lartë se nivelet që i takonin dhe përfunduan duke e quajtur biri i Allahut.”⁵²

Në këtë hadith, janë krahasuar jahuditë me Harixhi dhe Rafiditë me të krishterë. Vet Hz. Alia [r.a.] ka thënë:

“Për shkakun tim do të shkatërrohen dy grupe njerëzish. I pari, do të shkon larg në dashurinë ndaj meje dhe do të më mveshë edhe atë që nuk gjindet tek unë. Ndërsa, grupi i dytë do të më bëhen armiq dhe do të shpifin kundër meje.”⁵³

Të dy grupet kanë shkuar në skajshmëri, duke u ndarë nga grupi i drejtë, i mesëm që përfaqëson të vërtetën. Sepse, dashuria ndaj Hz. Alisë [r.a.] kurrë nuk është Rafidillëk, në të vërtetë Rafiditë, duke dashur Hz. Alinë [r.a.] bëhen armiq të tre halifeve shumë të rëndësishëm dhe as’habëve tjerë. Për këtë çështje, Imam Shafiu [rha] ka thënë kështu:

“Nëse dashuria ndaj Ehli Bejtit të Muhammedit [s.a.v.s.] është Rafidillëk, atëherë le të dëshmojnë njerëzit dhe xhinët e të gjitha botërave se unë jam Rafidi.”⁵⁴

Në këtë kuptim, dashuria ndaj Ehli Bejtit dhe as’habëve, në botën tonë të brendshme duhet të jetë e

⁵² Ahmed b. Hanbel, El-Musned, 1/160; Ebu Ja’la, el-Musned, nr. 530.

⁵³ Ibn Asakir, Tarihu Medineti Dimashk, 42/293.

⁵⁴ Razi, Mefatihul Gajb, 9/595.

njejtë. Ehli Bejtin dhe as'habët duhet dashur për hir të Allahut [xh.sh.] dhe Resulullahut [s.a.v.s.]. Kështu, Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] u drejtua duke treguar qartë në mënyrë esenciale masën e kësaj dashurie:

“Kush e do Allahun, e do Kuranin. Kush e do Kuranin më do mua. Kush më do mua i do edhe as'habët dhe akrebatë (të afërmit) e mi.”⁵⁵ Do të thotë, kjo dashuri, duhet të jetë fryt i dashurisë për Allahun [xh.sh.] dhe Resulullahun [s.a.v.s.]. nëpërmjet së cilës arrihet kënaqësia e Allahut [xh.sh.].

Dashuria e tërësishme për Ehli Bejtin i është bërë nasib [i është dhënë] Ehli sunnetit

Allahu Teala dëfton në një ajet:

“Allahu është i kënaqur ndaj tyre, e edhe ata të kënaqur prej Tij. [98-Bejjine: 8]”. Me këtë ajet, Allahu Teala tregon se është i kënaqur dhe i do të gjithë as'habët. Kjo kënaqësi e Allahut me as'habët nuk ndryshon asnjëherë. Të mveshurit e as'habëve me ndonjë mangësi apo të keqe, nënkupton mosbesim në këtë ajet.

Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] thotë se asnjëri nga sahabet nuk mund të bëhet qafir [mohues] dhe të gjithë do të hyjnë në xhenet, e na ka ndaluar të zgjaturit e gjuhës për secilin as'hab.⁵⁶ Asnjëri nga as'habët nuk mund të bëhet murted [i dalur feje] apo munafik [hipokrit]. Munafikët [hipokritët] nuk janë prej as'habëve. Pasiqë disa nga munafikët, më vonë kanë shpallur që nuk kanë besuar, nuk do të thotë se ndonjëri nga as'habët

⁵⁵ Tirmidhi, Menakib, 31.

⁵⁶ Tirmidhi, Menakib, 58.

është bërë murted [i dalur feje]. Dihet se në mesin e as'habëve ka pasur munafikë [hipokritë]. Në fillim të islamit gjendja e tyre nuk ishte e qartë. Por, në vitet e fundit të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] u ndanë munafikët nga muminët. Pas vdekjes së Resulullahut [s.a.v.s.] asnjëri nga këta munafikë nuk mbeti gjallë. Kështu, Hakk Teala thotë:

“Allahu nuk i lë besimtarët në gjendjen në të cilën ndodheni ju besimtarë tani, por do ta ndajë të keqin [munafikun] prej të mirit [muminit].” [3- Ali Imran: 179].

As'habët duhet t'i duam pasi që janë shokët e Resulullahut [s.a.v.s.] Sepse as'habët janë të nderuar së tepërmi lartë. Të tjerët nuk mund të arrijnë këtë nder. Shikimi i bekuar i Resulullahut [s.a.v.s.] iu ka dhënë këtë nder, duke iu dhënë ndihmë të madhe shpirtërore. Ata për të cilët është thënë në hadith:

“Një mysliman që më sheh mua, ose sheh atë që më ka parë mua, zjarri nuk e prekë.”⁵⁷

Si mund të tregohet më bukur se ç'do të thotë pasimi i një as'habi apo as'habëve? A thua ngritja në këtë pozitë shumë të lartë, mund të fitohet vetëm duke qenë mysliman dhe me një shikim të Hz. Muhammedit [s.a.v.s.] apo me një moment të këtij shikimi? A thua çfarë shikimi është ky, që atë që e shikon, zjarri nuk e prekë. Edhe atë që është shikuar edhe atë që shikon atë që është shikuar, zjarri nuk e djegë. Për këtë arsye, asnjë veli nuk mund të ngritet në shkallën e as'habëve. Sepse, as'habët kanë qenë prezent në muhabetin më të mbarë në tërë njerëzimin. Për këtë, personaliteti aq i ngritur Hz.

⁵⁷ Tirmidhi, Menakib, 56 (nr. 3858).

Vejsel Karani [r.a.], për shkak se nuk e ka parë Hz. Pejgamberin [s.a.v.s.] nuk ka arritur as në nivelin më të ulët të as'habëve. Kështu, Abdullah b. Mubarek [rha] e kanë pyetur:

“Cili nga këta është më i hajrit dhe ka gradë më të lartë: Hz. Muaviu [r.a.] apo Omer b Abdulaziz [rha]?”
Abdullah b. Mubareku [rha] është përgjigjur:

“Hz. Muaviu [r.a.] duke qenë bashkë me Resulullahun [s.a.v.s.] dhe duke ecur bashkë me të, edhe pluhuri që i ka ra kalit të Hz. Muaviut [r.a.] ka qenë më i lartë sesa Abdulazizi [rha].”⁵⁸

Po, dashuria e tërësishme edhe për Ehli Bejtin edhe për as'habët i është bërë nasib vetëm Ehli sunnetit. Përveç Ehli sunnetit, askujt nuk i është bërë nasib, sepse mosdashja e Ehli Bejtit është bërë Harixhillëk. Ndërsa kundërshtimi i as'habëve është Rafidillëk. Besimi i Ehli sunnetit është të duhet Ehli Bejti dhe të tregohet respekt dhe dashuri për të gjithë as'habët.

⁵⁸ Imam Rabani, Mektubat, Letra 207.

Në cilin grup jeni ju?

Në një rast, një grup njerëzish erdhën nga Iraku afër Hz. Zejnelabidinit [r.a.] Ata që erdhën, filluan të flasnin para-e-prapa për Hz. Ebu Bekrin [r.a.], Hz. Omerin [r.a.] dhe Hz. Osmanin [r.a.] Me këtë dëshironin të tregonin dashuri ndaj Hz. Aliut [r.a.] dhe fëmijëve të tij. Kur përfunduan fjalët, Hz. Zejnelabidini [r.a.] iu drejtua atyre duke i pyetur:

- A më thuani se kush jeni? A mos jeni ju nga muhaxherët që kanë qenë besnik ndaj Hakut, myslimanët e parë që na tregon Kurani, që e keni lënë atdheun dhe pasurinë dhe jeni shpërngulur për hir të Allahut [xh.sh.], që i keni dalur në ndihmë Allahut [xh.sh.] dhe Resultit [s.a.v.s.]?

Ata thanë:

- Jo, ne nuk jemi nga ata muhaxherë që i përshkruajte. Hz. Zejnelabidini [r.a.] iu tha:

- Në rregull, atëherë a mos jeni nga ensarët, që Medinen keni atdhe tuajin, që ka hyrë imani në zemrat tuaja, dhe që afër ju qëndrojnë vëllezërit myslimanë që kanë bërë hixhret e ju i doni, atyre iu jepni përparësi ndaj vetes, ia plotësoni nevojën vëllaut që ka bërë hixhret para nevojës suaj? Njerëzit u përgjigjën:

- Jo, ne nuk jemi nga ata që i përshkruajte. Atëherë Hz. Zejnelabidini [r.a.] tha:

- Ju thoni se nuk jeni nga këto dy grupe. Po e shoh se nuk jeni as nga ata që Allahu Teala i lavdëron.

“Dhe ata [Muminët/ besimtarët] që vijnë pas tyre [muhaxhirëve dhe ensarëve] e thonë: Rabi ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat tona farë

urrejtje ndaj atyre që besuan. Rabi ynë, Ti je me të vërtetë i butë, mëshirues.” [59-Hashr: 10].

Pasiqë e lexoi këtë ajet Hz. Zejnelabidini [r.a.], krejt këtë e bëri për t’iu tërhequr vërejtjen atyre, sepse u shqetësua shumë ndaj fjalëve të tyre për as’habët e mëdhenj. Më pas tha:

- Largohuni prej meje. Allahu le t’iu japë atë që e meritoni.⁵⁹

“Duajeni Ehli Bejtin e Resulullahut [s.a.v.s.] duke pasur kujdes për kënaqësinë dhe hatrin e Resulullahut [s.a.v.s.]” - Hz. Ebu Bekri [r.a.].

Balta e Ehli Bejtit është gatuar me ujin e vahjit [shpalljes]; brenda është mbjellur pema e peygamberllëkut; ajo pemë është ujitur me ujin e shpalljes hyjnore. Kjo pemë nuk jepë erë tjetër përveç miskut të hidajetit [udhëzimit] dhe amberit të takvasë [devotshmërisë].” - Jahja b. Muadh [k.s.].

Ndriçoni zemrat e juaja me dashurinë ndaj Ehli Bejtit. Nuri i ndritshëm prej qenies së tyre shpërndahet. Nga horizontet e tyre lindin diejt e fatbardhësisë. Allahu Teala kur i dëshiron dikujt hajrin (mbarësinë) dhe mirësinë, ai përshtatet trashëgimisë së Ehli Bejtit të Hz. Peygamberit [s.a.v.s.], i dojnë ata, interesohen për ta, dhe ruajnë drejtësinë e Resulullahut [s.a.v.s.] dhe Ehli Bejtit të tij. - Sejjid Ahmed Rufai [k.s.].

⁵⁹ Ebu Nuajm, Hiljetul Evlija, 3/161.

KAPITULLI I PESTË

DASHURIA E TË MËDHENJËVE NDAJ EHLI BEJTIT

Dashuria e as'habëve ndaj Ehli Bejtit

Me sakrificë ndaj Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] që nuk është parë ndonjëherë, dorëzueshmëri duke dhënë për te edhe pasurinë edhe shpirtin, me dashuri e dashuri, as'habët nuk kanë pasur asnjë mangësi në dashurinë dhe respektin për Ehli Bejtin e Resulullahut [s.a.v.s.] As'habi-Kiram, sikur në çdo vepër të hajrit, ashtu edhe në dashuri ndaj Ehli Bejtit, kujdes të veçantë dhe respekt të lartë për ta, janë bërë shembull për ne.

Të gjithë as'habët, kanë treguar kujdes të madh ndaj dashurisë dhe respektit për Ehli Bejtin. Kujdesin e veçantë kanë pasur jo vetëm për familjen e ngushtë të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.], por të njejtin kujdes kanë treguar edhe për familjen e gjërë, akrebatë [të afërmit] dhe trashëgimtarët e sojit të tij. Kështu me një rast, nga

as'habët e mëdhenj, dhe i njohur me dije të madhe në atë kohë, Zejd b. Sabit [r.a.] pasi ka falur një namaz të xhenazes, duke hypur në kali, djali i axhës së Pejgamberit [s.a.v.s.] - Abasit, Abdullahu [r.a.], për respekt të diturisë ndaj Zejd b. Sabiti [r.a.], i kapi frerët e kalit. Me të parë këtë, Zejdi [r.a.], i tha:

- O djali i axhës së Resulullahut [s.a.v.s.] të lutem mos ma bë këtë, lëshoji frerët. Abdullah b. Abasi [r.a.] i tha:

- Ne jemi të urdhëruar të bëjmë këtë respekt ndaj dijetarëve. Në këtë, Zejd b. Sabiti [r.a.] menjëherë i kapi dhe i puthi dorën, dhe tha:

- Edhe ne jemi urdhëruar të sillemi kështu ndaj Ehli Bejtit të Resulullahut [s.a.v.s.].⁶⁰

Abdullah b. Omeri [r.a.] rrinte nën hijen e Qabes. E pa duke ardhur Hz. Husejnini [r.a.], e tha:

“Sot më i dashuri i banorëve të qiellit, mbi sipërfaqen e tokës është ky”.

Ibn Mesudi [r.a.] ka thënë: “Një ditë të ushqehesh me dashurinë e Ehli Bejtit, është më e vlefshme se të bësh një vit ibadet nafle [adhurim vullnetar].”⁶¹

Dashuria e Hz. Ebu Bekrit [r.a.] ndaj Ehli Bejtit

Hz. Ebu Bekri [r.a.] nga mesi i as'habëve ka pasur një dashuri dhe lidhje të posaçme me Hz. Pejgamberin [s.a.v.s.]. Edhe qëndrimi ndaj Ehli Bejtit të tij ka qenë i tillë. Thënia e Hz. Ebu Bekrit [r.a.] na tregon shumë bukur këtë të vërtetë:

⁶⁰ Taberani, el-Muxhemul Kebir, nr. 4746; Hejsemi, Mexhmau-Zevaid, 9/345.

⁶¹ Dejlemi, Firdeusul-Ahbar, nr. 2543.

“Vallahi, ruajtja e të drejtave të të afërmve të Resulullahut [s.a.v.s.], është më e dashur për mua se ruajtja e të drejtave të të afërmve të mi.”⁶²

Në një rast tjetër, është drejtuar kështu:

“Duajeni Ehli Bejtin e Resulullahut [s.a.v.s.] dhe kujdesuni për kënaqësinë dhe hatrin e tij.”⁶³

Në një transmetim të Enes b. Malikut [r.a.], Hz. Ebu Bekri [r.a.] ndodhej në një xhematë të madh në Mesxhidun-Nebevi, në prezencën e Resulullahut [s.a.v.s.], Hz. Aliu [r.a.] hyri brenda, dha selam dhe kërkoi vend për t’u ulur. Këtë situatë Resulullahu [s.a.v.s.] e vështroi me kujdes dhe shikoi se kush do t’ia lëshoi vendin. Në atë moment, Hz. Ebu Bekri [r.a.], i cili ishte ulur në anën e djathtë të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] u tërheq anash dhe iu drejtua Hz. Aliut [r.a.]:

- Eja këtu o Ebul-Hasan. Hz. Aliu [r.a.] erdhi dhe u ulë në atë vend. Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] ishte shumë i kënaqur nga ky veprim i Hz. Ebu Bekrit [r.a.] dhe fytyra e tij tregonte gëzim. Duke iu drejtuar Hz. Ebu Bekrit [r.a.] i tha:

- O Ebu Bekër, faziletet [vlerat] më të larta i dijnë vetëm ata që kanë fazilete (vlerë të lartë).⁶⁴

Ky është një shembull i mirë se si Hz. Ebu Bekri [r.a.], i cili duke qenë më i vjetër në moshë se Hz. Aliu [r.a.], duke treguar këtë respekt ndaj tij i pari nga as’habët e pranishëm, tregoi një respekt, dashuri dhe kujdes të veçantë ndaj Ehli Bejtit.

Sipas transmetimit të Ukbe b. Haris [r.a.], Hz. Ebu Bekri [r.a.] fali namazin e ikindisë dhe doli nga xhamia.

⁶² Buhari, Fezailu As’habi-Nebi, 12.

⁶³ Buhari, Fezailu As’habi-Nebi, 12, 22.

⁶⁴ Ibn Asakir, Tarihu Medineti Dimashk, 42/365.

Atëherë, pau Hz. Hasanin [r.a.] duke luajtur me fëmijë. E mori në krahë dhe i tha:

“T’u bëfsha kurban! Sa po i përngjanë Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.], e jo Aliut [r.a.]” Duke thënë këtë, ishte afër Hz. Aliu [r.a.] dhe buzëqeshi për këto fjalë.⁶⁵

Dashuria e Hz. Omerit [r.a.] ndaj Ehli Bejtit

Nga as’habët e mëdhenj dhe i dyti nga Hulefa-i-Rashidinët [Halifët e drejtudhëzuar], Hz. Omeri [r.a.], çdoherë ka treguar kujdes shumë të veçantë, dashuri, respekt dhe nder për Ehli Bejtin. Hz. Omeri [r.a.] që ka qëndruar pranë Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] dhe ka qenë i lavdëruar prej tij, asnjëherë nuk ka ngecur në dashurinë dhe respektin e duhur ndaj Ehli Bejtit. Kjo shihet në transmetime të ndryshme. Nga shembujt më të dukshëm të rëndësisë së Ehli Bejtit për Hz. Omerin [r.a.], është në vitin 20 Hixhri. Ai ka përpiluar një Divan, i njohur si libri i rrogave, ku në fillim të atij libri, i ka rradhitur së pari gratë e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.], pastaj ata që i takojnë Ehli Bejtit dhe sipas afërsisë akrebatë (të afërmit) e Resulullahut [s.a.v.s.] Në një rast Hz. Omeri [r.a.] e ka parë një njeri duke përfolur dhe turpëruar Hz. Aliun [r.a.] Omeri [r.a.] iu drejtua:

- Turp për ty! A e di ti se kush është Hz. Aliu [r.a.]? Atëherë duke u drejtuar kah varri i Resulullahut [s.a.v.s.] Ai (Hz. Aliu r.a.) është djali i axhës së Muhammedit [s.a.v.s.] Vallahi, ti vetëm se po e mundon këtë në varr.⁶⁶

⁶⁵ Buhari, Fezailu As’habi-Nebi, 22.

⁶⁶ Ibn Asakir, Tarihu Medineti Dimashk, 42/519.

Në një transmetim Hz. Hasani [r.a.] ka thënë:

“Një ditë e pashë Hz. Omerin [r.a.], duke dhënë hutbe në minberin e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]. Edhe unë hipa në minber dhe i thash:

- Zbrit nga minberi i babës tim e hyp në minberin e babës tënd. Ndërsa ai më tha:

- Babai im nuk ka minber që të hyp në minberin e tij. Atëherë më mori edhe mua, barabartë me të dhe qëndruam në minber. Pasi zbritëm nga minberi më dërgoi në shtëpi dhe më tha:

- Evlad! Kush t’i mësoi këto fjalë? Unë i thash:

- Askush nuk m’i mësoi. Pastaj më tha:

- Kur të duash eja tek ne.

Pas një kohe shkova te Hz. Omeri [r.a.] Ishin duke diskutuar me Hz. Muaviun [r.a.] një rast edhe djali i tij Abdullahu, priste tek dera dhe nuk hynte. Kur pashë këtë, u ktheva.

Kur më pa më vonë, më pyeti:

- Ti kishë për të ardhur një ditë, pse nuk erdhe?

Unë i thash:

- Unë erdha njëherë, por ishe vetëm me Muaviun [r.a.], bile edhe djalit tënd Abdullahut nuk i kishë dhënë leje për të hyrë. Kur pashë këtë u ktheva. Ai më tha:

- Biri im, ti je para Abdullahut! Në këtë pozitë që po më sheh, e arrita së pari nga Allahu [xh.sh.] e pastaj në saje të juajen. Dhe më vendosi dorën mbi kokë.⁶⁷

“Kur e shoh dikë nga Ehli Bejti, është sikur të kem parë dikënd nga As’habi-Kiramët.” – Fudajl b. Ijaz

⁶⁷ Hatib, Tarihu Bagdad, 1/141.

Dashuria e Hz. Osmanit [r.a.] për Ehli Bejtin

Nga as'habët e mëdhenj dhe i treti prej Hulefa-i-Rashidinëve [Halifët e drejtudhëzuar], Hz. Osmani [r.a.], edhe para se të ishte halife, edhe gjatë hilafetit, ka treguar kujdes, dashuri dhe respekt ndaj Ehli Bejtit. Posaqërisht, gjatë kohës së hilafetit të tij, çdoherë kur është takuar me Hz. Abasin [r.a.], axhën e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.], për dashurinë dhe respektin që ka shfaqur ndaj tij, ka zbritur nga kali apo devja dhe ka treguar respekt dhe lavdërim.⁶⁸

Dashuria e të mëdhenjve për Ehli Bejtin

Dijetarët prijës të Ehli sunnetit, burimi i diturisë dhe irfanit, imamët e methhebeve Hanefi, Maliki, Shafi dhe Hanbeli: Numan b. Sabiti, Malik b. Enesi, Muhammed b. Idrisi dhe Ahmed b. Hanbeli [rha], kanë pasur kujdes deri në shkallën e fundit dhe kanë ruajtur dashurinë ndaj Ehli Bejtit. Do të përmendim disa shembuj të qëndrimeve dhe sjelljes së imamëve të Ehli sunnetit ndaj Ehli Bejtit.

Imam Azami – Ebu Hanifja

Imam Azami, Ebu Hanifja [rha], ka treguar nderim dhe respekt të lartë ndaj Ehli Bejtit. Ai është munduar t'i ndihmonte çdoherë edhe ata që shfaqnin nevojë, por edhe ata që nuk shfaqnin nevojë për ndihmë. Në një rast, njëri nga Ehli Bejti që fshihte nevojën për ndihmë, pasi që mori vesh, i dërgoi ndihmë prej 12 000 dirhem parashë.

⁶⁸ Ibn Asakir, Tarihu Medineti Dimashk, 26/354.

Gjithashtu, Imam Azami [rha], në çdo rast, këshillonte shokët dhe nxënësit e vet për dashuri, ndihmë dhe respekt ndaj Ehli Bejtit.⁶⁹

Një ditë Hz. Imam Azami [rha], duke dhënë ders, derisa ishte ulur, ngritej disa herë prej vendit. E pyetën për arsyen e ngritjes, ndërsa ai u përgjigj:

“Në oborr, janë duke luajtur disa fëmijë, e në mesin e tyre ka edhe sejjidë. Sa herë që po i shoh ata, po ngritem në këmbë.”⁷⁰

Imam Maliku

Në kohën e hilafetit abasit, kur Ebu Xhafer Mensuri ishte halife, Imam Maliku [rha] ishte rrahur me kamxhik me urdhërin e valiut të Medines Xhafer b. Sulejmanit. Aq shumë është rrahur, saqë populli e ka dërguar në shtëpi në gjendje të pavetëdijshme. Kur ka ardhur në vetëdije, fjalët e para që iu tha atyre që ishin afër janë:

- Ju jeni dëshmitarë se hakun tim i bëj hallall atij që ka dhënë urdhër për të më rrahur.

Këto fjalë iu dukën shumë të çuditshme të pranishmëve. Ishte shumë vështirë për ta të kuptonin se si Imam Maliku [rha] i bëri hallall, pas asaj rrahje të pamëshirshme. E pyetën Imam Malikun [rha] për shkakun e kësaj. Ai u përgjigj:

- Unë frikësohem që pasi të vdes edhe takohem me Resulullahun [s.a.v.s.] dhe dikush nga soji i tij dërgohet në xhehnm për shkakun tim. Për këtë turpërohem.⁷¹

⁶⁹ Ibn Haxher el Hejtemi, Es-Savaikul Muhrika, f. 180.

⁷⁰ Mevlana Safi, Reshehat, f. 196.

⁷¹ Ebu Bekër el-Hadrami, Reshefetu-Sadi, f. 162.

Halife Mensuri kur mori vesh për këtë rast, deshi ta dënojë valiun Xhafer b. Sulejmanin, mirëpo Imam Maliku [rha] nuk e lejoi dhe i tha:

- Kërkoj mbrojtjen e Allahut në këtë. Betohem në emrin e Allahut [xh.sh.] se për çdo goditje që më është dhënë, ende pa u ngritur kamxhiku nga trupi im, për hir të afërsisë ndaj Resulullahut [s.a.v.s.], i bëja hallall hakun tim.⁷²

Imam Shafiu

Imam Shafiu [rha] ishte shumë përpara në muhabetin [dashurinë] ndaj Ehli bejtit. Aq përparësi i jepte sa që dashurinë ndaj Ehli Bejtit e cilësonte si farz, duke thënë:

“O Ehli Bejt i Resulullahut [s.a.v.s.]! Dashuria ndaj jush, është bërë farz në Kuran nga Allahu [xh.sh.] Ata që nuk luten për ju në namaz [dërgimi i salatit], nuk iu pranohet namazi. Kjo e tregon nderin dhe pozitën tuaj të lartësuar.”⁷³

Prej muhabetit [dashurisë] të shumtë për Ehli Bejtin ka marrë edhe kritika. Posaqërisht nga Harixhitë është gjykuar si Rafidi. Për këtë arsye, është sjellur në Bagdad këmbë e duar lidhur. Si përgjegje në këto kritika, këto fjalë kuptimplota iu derdhën nga goja:

“Nëse dashuria ndaj Ehli Bejtit të Muhammedit [s.a.v.s.] është Rafidillëk, atëherë le të dëshmojnë njerëzit dhe xhinët e të gjitha botëve se unë jam Rafidi.”⁷⁴

⁷² Ibn Haxher el Hejtemi, Es-Savaikul Muhrika, f. 180.

⁷³ Shafi, Divani, f. 72; Sheblenxhi, Nurul Ebsar, f. 269.

⁷⁴ Razi, Mefatihul Gajb, 9/595.

Imam Shafiu dhe Sejjide Nefiseja

Dijetarët dhe velijtë nga të gjitha anët e Egjiptit e vizitonin Hz. Nefisen [r.anha] për të marrë bereqet dhe për të dëgjuar fjalët e ndershme me urtësi. Ndër vizitorët kryesor ishte Hz. Imam Shafiu [rha.]. Imami shkonte në mbledhinë e saj pas perdes dhe dëgjonte hadithe, dituritë dhe muhabetin e saj. Ibnu'l Mulakin kishte thënë:

“Imam Shafiu [rha], kur vinte në Egjipt, shumë shpesh vizitonte Sejjide Nefisen [r.anha]. Gjatë muajit të Ramazanit, falte teravinë në mesxhidin e saj. Kërkonte dua prej saj dhe dëgjonte hadithe sherif.”

Në çdo rast, kur Imam Shafiu [rha] sëmurej, e dërgonte njërin nga nxënësit e tij⁷⁵ tek Sejjide Nefiseja [r.anha] për të bërë dua. Nxënësi [djali i axhës] shkonte, i jepte selam dhe i drejtohej:

- Djali i axhës, Shafiu është sëmurë. Pret prej jush të bëni dua për te. Sejjide Nefiseja [r.anha] çdoherë bënte duanë:

- Allahu [xh.sh.] i japtë shëndet.

Sa herë kthehej nxënësi, e shihte Imam Shafiun shëndoshë e mirë.

Pas një kohe, Imami ishte sëmurë prapë. Por kjo sëmundje do të bëhej sëmundja e tij e fundit, sepse kjo do të shkaktonte vdekjen e tij. Si çdoherë, edhe këtë herë e dërgoi një nxënës për të kërkuar dua, por kësaj rradhe Sejjide Nefiseja [r.anha] e pikëlluar tha:

- Allahu [xh.sh.] e nderoftë me shikimin e Xhemalullahut [Bukurisë së Allahut] të Tij.

Nxënësi u kthye dhe duke i treguar për gjendjen, Imam Shafiu [rha] e kuptoi se sëmundja e tij është

⁷⁵ Në përgjithësi ka dërguar Rebi el-Xhezi apo Rebi el-Muradi.

shkaktare për vdekjen, bëri përgatitjet për vdekje, shkroi trashëgiminë dhe la amanet që Sejjide Nefiseja [r.anha] të vjen në xhenazen e tij.

Pas një kohe erdhi urdhëri Hak. Imam Shafiu [rha] shkoi në rahmetin [mëshirën] e Allahut. Por Sejjide Nefiseja [r.anha] ishte shumë e lodhur, saqë gjendja e saj nuk e lejoi të shkonte në xhenaze. Për këtë, e dërguan xhenazen atje ku gjindej Sejjide Nefiseja [r.anha] Gruaja e bekuar u ndal tek fundi i xhematit dhe u lidh pas imamit për namazin e xhenazes. Pas namazit, u dëgjua një zë:

“Ata që janë falur në namazin e xhenazes së Imam Shafiut, për hatër të tij Allahu Teala i fali dhe Allahu Teala e fali Imam Shafiun [rha], për hatër të Sejjide Nefises [r.anha] që gjindej në namazin e xhenazes.”⁷⁶

Imam Ahmed b. Hanbeli

Themeluesi i methhebit [shkollës juridike] Hanbeli, Ahmed b. Hanbeli [rha], kush shkonte te ai, nga ata që i përkisnin fisit Kurejsh të Resulullahut [s.a.v.s.] ose Ehli Bejtit, i ri apo i vjetër, i vendoste përpara dhe ecte prapa tyre.⁷⁷

Ma jep besën!

Halifja e Mevlana Halid Bagdadit [k.s.], ka qenë Sejjid Abdulgafar Halidi Mushahidi [k.s.] Mevlana Halid Bagdadi [k.s.] i bënte atij respekt të lartë. Një ditë kur doli nga mesxhidi, e pau Sejjid Abdulgafarin [k.s.] ulur. U afrua afër tij dhe për dashurinë ndaj Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] ia kapi dhe uthi dorën dhe pastaj tha:


⁷⁶ Sheblenxhi, Nurul Ebsar, f. 447.

⁷⁷ Ibn Haxher el Hejtemi, Es-Savaikul Muhrika, f. 180.

- Pa më dhënë besën se në ditën e Kijametit, do të më futësh edhe mua nën sanxhakun e gjyshit tënd Hz. Muhammedit [s.a.v.s.] nuk ta lëshojë dorën.

Sejjid Abdulgafari [k.s.] nën ndikimin e këtyre fjalëve të bukura, ra dhe u pak. Afër tre orë qëndroi në atë gjendje⁷⁸

⁷⁸ Enciklopedia e evlijas, 1/297



KAPITULLI I GJASHTË

AHLAKU I EHLI BEJTIT

Ahlaku i Ehli Bejt

Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] që është dërguar në ahlakun më të lartë, është përfaqësues i ahlakut të bukur, të mirë dhe model i së mirës. Kështu që, sunneti i tij është formuar në modelin e mënyrës së jetesës së tij. Njerëzimi, prej asaj kohe, duke shikuar nga dritarja e tij, ka pasur mundësi të shoh më kthjelltë të mirën dhe të keqen, të drejtën dhe të kotën, hijeshinë dhe të shëmtuarën.

Ai është Pejgamber i rahmetit [mëshirës]. Për këtë arsye, në ditën e Uhudit, kur faqja i është qarë dhe dhëmbi i tij i bekuar i është thyer, është kërkuar prej tij të bëjë beddua [dua mallkimi], kësaj kërkesë iu përgjigj:

“Unë nuk jam dërguar si mallkues. Unë jam dërguar vetëm për davet [thirrje] dhe rahmet [mëshirë] për të gjitha botët.”⁷⁹

⁷⁹ Muslim, Birr, 24 (nr. 87).

Ky ahlak prej tij ka kaluar edhe te Ehli Bejti i tij. Sikur në çdo çështje që kanë marrë shembull gjyshin e tyre, ashtu edhe në ahlak ai ishte shembulli i tyre.

Një ditë dikush i kishte thënë fjalë të këqija Hz. Zejnelabidinit [r.a.], të birit të Hz. Husejnit [r.a.]. Edhe pasi i foli ato fjalë, Hazreti e zhveshi rrobën e tij dhe ia dhuroi.⁸⁰

Sipas transmetimit të Abdulgafar b. Kasimit, Hz. Zejnelabidini [r.a.] doli një ditë nga shtëpia për të shkuar në xhami. Rugës duke shkuar, njëri e shau atë. Shoqëruesit e tij, u drejtuan kah ai që shante. Por Hz. Zejnelabidini [r.a.] e pengoi këtë, i qetësoi ata, pastaj iu drejtua atij dhe i tha:

- Ti ende nuk di fare për shumë turpërime të mijat. A ke ndonjë nevojë të të ndihmojë? Njeriu u turpërua dhe u pendua për atë që kishte bërë. Hz. Zejnelabidini [r.a.] i dha 1000 dirhem dhe xhyben e vet e zhveshi dhe ia dha. Njeriu duke u ndarë prej tij, përsëriste fjalët:

- Unë dëshmoj se ti je nga evladët e Resulullahut [s.a.v.s.]!...

Mirësjellja e Ehli Bejtit

Resuli i Allahut [s.a.v.s.] kishte buzëqeshje në fytyrë, natyrë të edukuar dhe të hijshme dhe shumë i hollë e i ndjeshëm në shpirt. Nuk ishte me zemër të fortë, i sertë dhe i dhunshëm. Kurrë nga goja e tij nuk kanë dalur fjalë të vrazhda. Kështu, në Kurani Kerim, në një ajet thuhet:

“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë,e sikur të ishe i vrazhdë e

⁸⁰ Sharani, Tabakatul Kubra, 1/32; Gazali, Ihjau-Ulumid-Din, 3/1667.

zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje.” [3-Ali Imran: 159]

H. Enesi [r.a.] tregon:

“Ishim duke ecur së bashku me Resullullahun [s.a.v.s.]. Ai kishte veshur një xhybe të punuar me material të fortë anash, të quajtur Nexhran. Erdhi një beduin dhe e tërhoqi për xhybeje, sa që iu skuq qafa Resuli Ekremit [s.a.v.s.] dhe xhybja la shenjë në qafën e tij të bekuar. Pas kësaj beduini tha:

- O Muhammed [s.a.v.s.]! M’i mbush këto dy deve të mia me mallëra të ganimetit [fitimi i luftës]! Pse a mos po më ngarkon nga malli yt apo i babës tënd!

Resullallahu [s.a.v.s.] pasi heshti për disa çaste, iu drejtua kështu:

- **Malli është i Allahut, e unë jam rob i Tij...**

Pas këtyre fjalëve vazhdoi:

- **O Arab! A dëshiron të ta kthej me të njëjtë për këtë që më bëre?** Bediuni iu përgjigj:

- Jo, sepse ti të keqen nuk e kthen me të keqe.

Në këtë përgjigje, H. Pejgamberi [s.a.v.s.] buzëqeshi. Pastaj urdhëroi t’i mbushin një deve me grurë dhe një tjetër me hurme.⁸¹

Ky ahlak i bukur i Resuli Ekremit [s.a.v.s.] ka kaluar edhe tek Ehli Bejti i tij, edhe ata kishin marrë një hise nga ky ahlak.

Njërin prej murshidëve të mëdhenj të Ehli Bejtit, H. Sejjid Abdulhakim Bilvanisin [k.s.] e pyetën:

Efendi! Disa po ju mohojnë juve, po bëjnë armiqësi ndaj jush, flasin fjalë të pahijshme kundër jush. Çka thoni ju për këtë?

⁸¹ Buhari, Edeb, 68; Ebu Davudi, Edeb, 1.

Sejjid Abdulhakim Bilvanisin [k.s.] u përgjigj me këto fjalë:

“Imam Shafiu [rha] ka thënë: Rabi im! Nëse do të më njihje të drejtën e shefatit [ndërmjetësimit] në prezencën e Allahit, më së pari iu kisha bërë shefat [ndërmjetësuar për] munafikëve [hipokritë], sepse ata na ndihmojnë vazhdimisht të ngritemi shpirtërisht.”

Edhe ne mendojmë sikur ky imam i madh. Ata duke na mohuar, bëhen shkaktar që ne të ngritemi shpirtërisht, e kështu edhe ne duhet të përgjigjemi me të mirë ndaj të mirës së tyre. Edhe ne me izën e Allahut Teala sikur këta të mëdhenj që kanë vepruar, i duam ata që na mohojnë.”⁸²

Ky personalitet i shquar, një ditë u sëmurë dhe shumë njerëz erdhën në vizitë. Disa sufi, deshën ta ndalonin këtë tollovi të vizitorëve. Por, Gavsi [Sejjid Abdulhakim Bilvanisi] i ndaloi këta sufi dhe iu tha:

“Lërimi sufitë, mos i prekni! Sepse ata veprojnë kështu nga muhabeti. Sikur të ishte në jetë Shahi Hazne [k.s.], [Murshidi i madh Ahmed El-Haznevi] unë ndoshta do ta kafshoja.”⁸³

Merhameti i Ehli Bejtit

Resuli i Allahut [s.a.v.s.] që është i dërguari i merhametit, ishte i mëshirshëm deri në shkallën më të fundit. Zemra e tij ishte e mbushur plot dhembshuri dhe njerëzishmëri. Ajo zemër ishte e mbushur përplot dashuri dhe ndjeshmëri. Për këtë, kohë pas kohe, sytë i përloteshin dhe nëpër fytyrën e tij të bekuar rrjedhnin

⁸² Ildirar-Çagil, Sejjid Abdulhakim el-Husejni dhe Tarikati Nakshibendi, f. 21.

⁸³ Ildirar-Çagil, Sejjid Abdulhakim el-Husejni dhe Tarikati Nakshibendi, f. 21.

lotë. Posaqërisht në çështje të umetit të vet, ishte shumë i mëshirshëm. Haku Teala e kishte krijuar atë në këtë natyrë. Kur Allahu Teala flet për te në Kuran,

“Juve ju erdhi i dërguari nga mesi juaj, atij i vie shumë rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është shumë i dhënë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët. [9-Teube: 128]

Me ahlakun e hijshëm që kishin Ehli Bejti, pa bërë dallim të mirë a të këqinj, për të gjithë myslimanët dhe për të gjitha shtazët, kanë qenë shumë të ndjeshëm. Askë nuk kanë kritikuar për fenë e tyre. Kjo ishte prej ahlakut të tyre më të ngritur. Ata janë trashëgimtarë të Resultit të Allahut [s.a.v.s.]. Për këtë arsye, ata ahlakun e tij e jetojnë në nivelin më të lartë [pedestal]. Ehli Bejti kanë marrë nga trashëgimia e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] edhe mëshirën. Për këtë arsye, ata mundohen të jenë të mëshirshëm dhe të dobishëm për të gjithë njerëzit. Nuk përzgjedhin njeriun. Mundohen të ndihmojnë për hir të Allahut Teala me krejt çka kanë në dorë. Çdo ndihmë që bëjnë, në sytë e tyre duket e vogël dhe nuk e përmendin asnjëherë. Zaten ndër veçantitë themelore të tesavufit janë edhe këto dy:

“Nënshtrim ndaj urdhërave të Allahut dhe dhembshuria ndaj krijesave të Tij.”

Falja e Ehli Bejtit

Ehli Bejti ka pasur qëndrim shumë të kuptueshëm, kanë mbyllur sytë, pra kanë falur edhe ata që kanë bërë ndonjë padrejtësi ndaj tyre, duke marrë shembull ahlakun e Resuli Ekremit [s.a.v.s.]. Në raste hidhërimi kanë pasur nën kontrollë situatën. Sepse Resulullahu [s.a.v.s.] nuk është hidhëruar ndaj askujt për neftin

[personalitetin] e vet, por vetëm për shkeljen e urdhërave të Allahut [xh.sh.] dhe në ato raste ka vepruar në mënyrën e duhur.

H. A. Ajshja [r.anha] thotë: “Nuk kam parë asnjëherë Resuli Ekrem [s.a.v.s.] të jetë zemëruar për ndonjë padrejtësi ndaj tij, por nëse dikush ka bërë një vepër që Allahu i Madhërishëm e ka bërë haram [e ka ndaluar], atëherë ai hidhërohej më së shumti.”⁸⁴

Sipas një transmetimi të Ebu Hurejres [r.a.],

Resuli Ekrem [s.a.v.s.] pas çlirimit të Mekës, pasi bëri tavaf Qaben dhe fali dy reqate namaz, duke mbajtur me dorë pragun e derës së Qabes iu drejtua mekasve dhe i pyeti:

- **Çfarë mendoni se do të veprojë dhe çfarë mendoni për mua?** Ata thanë tre herë:

- Ju jeni vëllau ynë, e djali i axhës tonë. Jeni njeri i mëshirshëm, i butë e i drejtë. Vetëm të mira priten nga ju. Resuli Ekrem [s.a.v.s.] iu tha:

- **Unë po iu them vetëm atë që i tha Jusufi vëllezërve të vet:**

“Sot nuk ka qortim kundër jush Allahu ju faltë juve; Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve.” [12-Jusuf: 92].

Në vazhdim Ebu Hurejre [r.a.] transmeton:

“Ata që dëgjuan këto fjalë të Resuli Ekrem [s.a.v.s.], sikur të zgjoheshin nga varrezat u drejtuan nga Resuli Ekremi [s.a.v.s.] për të pranuar Islam. ”⁸⁵

Të birit të Hz. Husejnit [r.a.], Hz. Zejnelabidinit [r.a.] i kishin ardhur mysafirë. Kërkoj nga shërbëtori ta sjellë mishin që piqej në oxhak. Shërbëtori duke nxituar kapi

⁸⁴ Buhari, Menakib, 23; Hudud, 10; Edebul Mufred, nr. 274.

⁸⁵ Shami, Subulul Huda ve Reshad, 5/242.

hekrin e nxehtë me mish dhe e rrëzoi mbi kokën e të birit të Hz. Zejnelabidinit [r.a.] dhe fëmija vdiç. Hz. Zejnelabidini [r.a.] i tha shërbëtorit të tij:

“Nuk e mbyte me qëllim. Ty të lirova, tani je i lirë!” dhe u mor me varrimin e të birit.”⁸⁶

“O Ehli Bejti i Resulullahut [s.a.v.s.]! Dashuria ndaj jush, është bërë farz në Kuran nga Allahu [xh.sh.]. Ata që nuk luten për ju në namaz (dërgimi i salatit), nuk iu pranohet namazi. Kjo e tregon nderin dhe pozitën tuaj të lartësuar. – Imam Shafiu [rha]

Fytyra e buzëqeshur e Ehli Bejtit

Prej ahlakut të bukur të Ehli Bejtit është edhe të genit i buzëqeshur ndaj muminëve [besimtarëve], fjalët e ëmbla dhe sinqeriteti.

Edhe në këtë çështje ata kanë marrë shembull Hz. Pejgamberin [s.a.v.s.] dhe këtë këshillë kanë pasur si udhërrëfyes.

“Nëse ju zemrat e njerëzve nuk mund t’i përfitoni dhe t’i kënaqni me pasurinë tuaj, atëherë silluni ndaj tyre me fytyra të buzëqeshura dhe ahlak të bukur.”⁸⁷

Po pra, ata janë të buzëqeshur dhe fjalëmbël. Sepse Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] ndaj askujt nuk ka mërrolur fytyrën. Ndaj çdokujt është sillur me buzëqeshje.

Me këtë ahlak të bukur, ata kanë përfituar shumë miq dhe kanë zënë vend në shumë zemra.

Sa bukur është shprehur Hz. Aliu [r.a.]:

⁸⁶ Ibnul Xheuzi, Sifatu Safue, 2/56.

⁸⁷ Tirmidhi, Birr, 58; Hakim, el-Mustedrek, 1/124.

“Kaloni një jetë të atillë që kur të vdisni edhe armiqët tuaj të qajnë.”

Modestia e Ehli Bejtit

Hz. Resulullahu [s.a.v.s.] gjindet në shkallën më të lartë në ahlakët e bukura. Ashtu ishte edhe në ahlakun e modestisë. Ebu Seleme e pyeti Ebu Said Hudriun:

“Çka mendon për këta njerëz që shpikën veshjen, ushqimin, pijen dhe mjetet e transportit?”

Ebu Said [r.a.] iu përgjigj:

“Nipi im, ha, pi e veshu për Allahun. Nëse në këto fillon ta pëlqesh veten e lavdërohesh, tregohesh dhe e tepron në shpenzime, atëherë është gjynah. Vepra në punët e shtëpisë ashtu siç ka vepruar Resuli Ekrem [s.a.v.s.].

Ai, devenë e lidhë, e ushqen, pastron e rregullon shtëpinë, e mjelë delen, i ndreqë mbathjet dhe harron robat. Ha me shërbëtorin dhe përgatit ushqimin, shkon në pazar për të blerë dhe sjellë në shtëpi. Bisedon me të pasur e të varfër dhe nuk bën dallimin i vogël- i madh, i bardhë - i zi, i lirë apo rob, i madh a i vogël, pa dallim, kur takonte cilindo mysliman i jepte selam i pari.

Nuk veshte rroba të veçanta vetëm përjashtë shtëpisë apo vetëm për shtëpi. Nuk bënte përgatitje të posaçme në ndonjë ftesë. Gjithmonë ishte në gjendje të mirë e të bukur. Nëse do të kishte vetëm hurme nuk e nënçmonte ftesën. Nuk përgatiste ushqim në mbrëmje për mëngjes apo në mëngjes për mbrëmje. Kalonte lehtë, kishte ahlak të butë, natyrë të bukur, ishte i shoqërueshëm, me fytyrë të qeshur, me buzëqeshje, ishte i mallëngjyer pa fytyrë të ngrysur a të mërrullur, ishte i ngadalshëm dhe serioz pa dukje të sertë. Ishte modest pa

qenë i poshtëruar, ishte gjymert [dorëshlirë] pa e tëpuar në shpenzim. Ishte i mëshirshëm dhe me zemër të butë për të afërmit dhe të gjithë myslimanët. Gjithmonë ecte duke shikuar para. Asnjëherë nuk e mbushte barkun tërësisht, nuk zgjaste dorën me grykësi apo me sy të uritur.⁸⁸

Ehli Bejti, duke u rritur në bankat e dijes së Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] kanë mbajtur rrugën e tij dhe janë bërë modest si ai.

Hz. Sejjid Ahmed Rufai [k.s.] një ditë i thoshte muridëve të tij:

- Kush sheh ndonjë gabim te unë, le të më tregon. Njëri prej muridëve iu përgjigj:

- Efendi, tek ju është një gabim i madh.

Ky njeri modest nuk u hidhërua fare dhe nuk u shqetësua që muridi i tij i tha se kishte ndonjë gabim. Vetëm me shpresë që të shpëtojë nga gabimi i vet, e pyeti:

- Fol, vëllau im, cili është gabimi im? Nxënësi me sy të përlotur i tha:

- Si ne të bëhemi nxënës të juaj?

Këto fjalë patën ndikim të madh në zemrat e të pranishmëve dhe të gjithë filluan të qajnë. Edhe Hz. Sejjid Ahmed Rufai [k.s.] qante. Në ato momente, mundi të thoshte vetëm këto fjalë:

- Unë jam shërbëtori juaj dhe më i ulëti nga ju.

Ndruajtja e Ehli Bejtit

Ahlaku i ndruajtjes prapë mund të shihet në mënyrën më të përsosur të Pejgamberi ynë [s.a.v.s.] Pejgamberi ynë [s.a.v.s.] siç ka qenë në çdo ahlak të mirë,

⁸⁸ Hajsemi, ez-Zevaid, nr. 14209.

ashtu edhe në pikëpamje të ndruajtjes, ishte më i larti dhe më i ndrojturi në mesin e njerëzve. Ai ishte në nivelin më të lartë në zotërimin e ndruajtjes. Për çdo gjë që konsiderohej e turpshme në pamje dhe në shfaqje ai kishte sytë e mbyllur. Edhe në këtë çështje, ishte më i edukuari nga mesi i njerëzve.

Ebu Said Hudri [r.a.] tregon: “Resulullahu [s.a.v.s.] ishte më i ndrojtur prapa perdes sesa vajza e virgjër. Nëse shihte diçka që nuk i pëlqente, ne e kuptonim menjëherë nga shprehja e fytyrës së tij.”⁸⁹

Enes b. Maliku [r.a.] tregon kështu:

Një ditë njëri e kishte lyer fytyrën me ngjyrë të verdhë dhe i doli para Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]. Nuk i tha asgjë atij. Kur doli jashtë njeriu, na u drejtua:

“Ti kishit thënë atij që të lajë ngjyrën që kishte në fytyrë!”⁹⁰

Duke marrë mësim për ndruajtjen nga Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.], Ehli Bejtë ishte ngritur në atë nivel, që në çdo veprim dhe qëndrim mund të shihej një aspekt i edukatës dhe ndruajtjes.

Xhymertllëku [Bujaria] i Ehli Bejtë

Xhymertllëku [Bujaria] i Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] ishte një prej vetive më të dukshme të tij. Ai ishte xhymert [dorëshlirë] deri në shkallën më të lartë. Asnjëherë nuk e kthente dikë që kërkonte diçka prej tij. Atë që kishte për të dhënë, e jepte pa hezitim. Kështu,

⁸⁹ Buhari, Menakib, 23; Edeb, 72/77; Edebul Mufred, nr. 467.

⁹⁰ Ebu Davud, Edeb, 6 (nr. 4789); Tirmidhi, Shemail, nr. 346.

Xhabir b. Abdullahu [r.a.] thotë: “Kur diçka është kërkuar prej Resulullahut [s.a.v.s.] kurrë nuk ka thënë “jo”.⁹¹

H. Aliu [r.a.] thotë kështu:

“Kur kërkonte dikush diçka prej Resulullahut [s.a.v.s.], nëse donte t’i plotësonte nevojën atij, thoshte “në rregull”; ndërsa, kur nuk dëshironte heshtte. Kështu që ai nuk ka thënë “jo” për asgjë.”⁹²

Tash të dëgjojmë një ngjarje që e rrëfen Hz. Omeri [r.a.]: Erdhi një fukara tek Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] edhe i kërkoi diçka. Por atë që ai i kërkoi, Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] nuk kishte. Kështu, Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] u mërzhit shumë që nuk pati atë që i kërkoi fukaraja. Atëherë Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] i tha të shkojë në çarshi ta blente atë, të shënojë emrin e Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] si borxhli dhe t’i thotë shitësit se do t’i kthejë borxhin në mundësinë e parë që do t’i jipej. Ai kishte ndihmuar edhe më parë të njejtin person. Duke e ditur këtë, Hz. Omeri [r.a.] e pyeti:

“Ja Resulallah, këtij personi i keni ndihmuar edhe më parë, a pati nevojë që t’ia plotësosh këtë kërkesë tani?” Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] nuk ishte i kënaqur nga këto fjalë të Hz. Omerit [r.a.]; kjo u kuptua nga shprehja e fytyrës së tij. Në atë çast, njëri nga ensarët shprehi mendimin e tij:

“Ja Resulallah, dhuro, se Allahu [xh.sh.] që është mbizotërues i Arshit, nuk ju le juve të bini në varfëri.”

Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] i pëlqeu mendimi i tij dhe u drejtua:

⁹¹ Buhari, Edeb, 39; Muslimi, Fezail, 14 (nr. 57).

⁹² Hejsemi, ez-Zevaid, 9/13; Kandehlevi, Hajatu-Sahabe, 3/78.

“Unë jam urdhëruar të mos frikësohem nga të dhuruarit dhe varfëria.”⁹³

Sipas një transmetimi, një njeri kërkoi ndihmë nga Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] dhe Resuli i Allahut [s.a.v.s.] urdhëroi t’i jepen dyzet dele. Kur u kthye njeriu tek fisi i tij, tha:

“O fisi im! Bëhuni myslimanë, Muhammedi [s.a.v.s.] nuk frikësohet nga varfëria dhe dhuron shumë.”⁹⁴

Sehl b. Sad [r.a.] tregon:

“I qepa Resulullahut [s.a.v.s.] një xhybe prej leshit të Enmarit dhe i bëra astarin nga bezi i zi. Pasi e veshi Resulullahu [s.a.v.s.] u drejtua:

“Shikoni sa i bukur dhe sa i butë”. Në atë çast, njëri nga beduinët u ngrit dhe tha:

“Ja Resulallah [s.a.v.s.], ma fal mua atë xhybe”. E kur është kërkuar diçka prej Resuli Ekremit [s.a.v.s.], ai nuk refuzonte kurrë. Menjëherë e zhveshi xhyben dhe ia dhuroi dhe urdhëroi t’i bëjnë edhe një. Derisa ishte duke u qepur xhybja, Resuli Ekrem [s.a.v.s.] shkoi në botën e përhershme.”⁹⁵

Njëherë një lypës, lypi nga Hz. Aliu [r.a.]. Ai i tha Hz. Hasanit [r.a.] ose Hz. Husejnit [r.a.]:

“Shko tek nëna, nga gjashtë derhemët që i kam dhënë, merr një dhe ma sjell.” Shkoi dhe me tu kthyer i tha:

“Nëna thotë që ato i ka fshehur për të blerë miell.” Hz. Aliu [r.a.] tha:

“Ai që ka në dorë diçka, e që nuk ka më shumë besim tek Allahu, nuk ka iman të plotë. Shko dhe m’i sjell

⁹³ Tirmidhi, Shemail, nr. 355; Hejsemi, ez-Zevaid, nr. 10/241.

⁹⁴ Muslim, Fezail, 14 (nr. 57), Ahmed b. Hanbel, el-Musned, 3/175.

⁹⁵ Kandehlevi, Hajatu-Sahabe, 2/235.

të gjitha paratë.” Kësaj rradhe Hz. Fatimja [r.anha] i dërgoi të gjitha paratë e Hz. Aliu [r.a.] të gjitha ia dha lypësit.

Në atë vend ku ndodhi kjo ngjarje, pas disa minutash erdhi një shitës devesh. Hz. Aliu [r.a.] e pyeti për çmimin e deves. Kur kuptoi që ishte 140 derhem, e pyeti:

“A ma shet, e paratë të t’i japë më vonë?” Shitësi e pranoi dhe e lidhi deven aty. Pas pak kohe, erdhi një njeri dhe pyeti se e kujt ishte devja. Hz. Aliu [r.a.] i tha se ishte i tij. Njeriu e pyeti:

“A ma shet?” Hz. Aliu [r.a.] ia shiti për 200 dirhem. Pasi i pagoi borxhin prej 140 dirhemësh, blerësit të deves, shkoi në shtëpi. Për 6 dirhemët që i mori pak më parë Hz. Fatimes [r.anha], i dha 60 dirhem. Ajo me çudi e pyeti Hz. Aliun [r.a.):

“Ç’është kjo?” Hz. Aliu [r.a.] iu përgjigj:

“Allahu Teala përmes Pejgamberit tonë [s.a.v.s.] thotë:

“Kush bën një vepër të mirë do të shpërblehet dhjetëfish.” [6-Enam: 160] Kjo është mënyra e përmbushjes së premtimit.”⁹⁶

Një fukara vinte te Hz. Zejnelabidini [r.a.], i biri i Hz. Husejnit [r.a.] dhe ky e priste shumë mirë, i vinte mirë që i ka ardhur, i jepte komplimente dhe i thoshte:

“Merhaba, mirë se ke ardhë. Ke ardhur që unë të fitojë ahiretin.”⁹⁷

Nga imamët e Ehli Bejtit, Hz. Xhafer Sadiku [r.a.] ishte shumë xhymert [bujar], aq shumë u jepte të

⁹⁶ Kandelevi, Hajatu-Sahabe, 2/223.

⁹⁷ Ibnul Xheuzi, Sifatul Safue, 1/449.

varfërve për të ngrënë e pirë, sa që shumë shpesh nuk mbetet asgjë për familjen.⁹⁸

Takvaja [devotshmëria] e Ehli Bejtit

Në islam, vlera dhe lartësia maten me takvallëk [devotshmëri]. Islami ka larguar nga mesi i vet çdo lloj ndarje apo mburrje në baza të ngjyrës, gjuhës, sojit, pasurisë, e të tjera, dhe ka lënë vetëm një vlerë matëse në mesin e tyre. Ajo quhet takvallëk [devotshmëri].

Pasi që devotshmëria është shpirti i të gjitha mirësive, në islam është pranuar si vlerë matëse e lartësisë. Tek Allahu Teala nuk shikohen pasuria, pozita, bukuria apo zotërimi i diçkaje, por afërsia ndaj Allahut [xh.sh.] shikohet vetëm në bazë të devotshmërisë.

Të mos harrojmë se e vetmja rrugë për afërsi dhe dashuri ndaj Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] pas imanit është takvaja [devotshmëria]. Pa iman [besim] dhe devotshmëri, afërsia që rrjedhë nga lidhja e gjakut nuk ka ndonjë ndikim.

Hz. Aliu [r.a.] thotë: “Atij që bënë vepra me devotshmëri, nuk i thuhet pak, sepse ato janë vepra të pranuar.” në ajetin e Allahut Teala:

“...Allahu pranon vetëm prej të devotshmit.”

[5-Maide: 27].⁹⁹

Në një rast tjetër ka thënë: “Zotëriu i njerëzve të kësaj bote është xhymerti [dorëshliri], ndërsa zotëriu i njerëzve të ahiretit është takvaja [i devotshmi].”¹⁰⁰

⁹⁸ Zehebi, Tezkiretul Huffaz, 1/166.

⁹⁹ Sharani, Tenbihul Mugterrin, f. 300.

¹⁰⁰ Kushejri, Risale, f. 108; Jafi'l, Neshrul Mehasin, f. 214.

Zotëriu ynë, Sejjidul-Enbija [s.a.v.s.] nuk i jepte fare rëndësi kësaj bote dhe të mirave të saj. I mjaftonte pak. Deri sa shkoi në botën e ahiretit u gjend në shumë raste betejash, zotëronte shumë, por megjithatë në kohën e vdekjes, kishte lënë peng shtatën tek një jahudi, për mallin e nevojshëm për familjen.¹⁰¹

Nëna jonë Hz. Ajshja [r.anha] ka thënë:

“Deri sa i mbylli sytë e tij të bekuar nga kjo botë, Resulullahu [s.a.v.s.] nuk ka kaluar tri ditë rresht duke u ngopur së ngrëni.”

Hz. Ajshja [r.anha] gjithashtu tregon:

“Ka ndodhur që për një muaj në shtëpinë tonë të mos ndizej zjarri për të përgatitur gjellë. Kishim vetëm ujë dhe hurme.”

Ibn Abasi [r.a.] tregon:

“Resulullahu [s.a.v.s.] dhe Ehli Bejti i tij, shumë netë kanë fjetur pa ngrënë asgjë. Nuk gjenin asgjë për të ngrënë në mbrëmje.”

Prapë, nëna jonë Hz. Ajshja [r.anha] tregon:

“Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] nuk ka mbushur kurrë me ushqim barkun e tij të bekuar. E për këtë nuk i është ankuar askujt. Kur kishte sa për të shuar urinë e etjen, ajo gjendje i dukej më e vlefshme se pasuria. Vërtitja natën prej urie, nuk e pengonte për të agjëruar të nesërmen. Vetëm po të dëshironte, mund të kërkonte nga Rabi i tij, tërë pasurinë, ushqimin dhe një jetë të rehatshme, por nuk e bënte këtë. Ju betohem se, kur e shihja në këtë gjendje më dhimbsej dhe qaja. Me dorë i fërkoja barkun e tij të bekuar dhe kur e pyeta:

¹⁰¹ Shih Buhari, Rehn, 2/5, Istikraz, 1, Xhihad, 89.

“Të qoftë falë shpirti im! A nuk bën të keshë disa gjëra që janë të dobishme për të të dhënë fuqi për këtë botë?” Ai m’u përgjigj:

“O Ajshe! Çfarë të bëj unë me këtë botë? Vëllezërit e mi, Pejgamberët, Ulul-Azam, kanë duruar edhe më vrazhdë se kaq. Por, ata vazhduan të jetojnë në atë gjendje. U takuan me Rabin e tyre. Për këtë arsye, Rabi iu bëri atyre kthim të bukur dhe sevapet e tyre i shtoi. Do të më vinte turp të jetojë një jetë në bollëk. Sepse ajo jetë do të më linte prapa tyre. Më e hijshme dhe më e dashur tek unë është të takohem me vëllezërit dhe shokët e mi dhe t’iu bashkangjitem atyre.”

Nëna jonë Hz. Ajshja [r.anha] thotë: “Pas këtyre fjalëve, Resulullahu [s.a.v.s.] ndërroi jetë pas afër një muaji.”¹⁰²

Sabri [durimi] i Ehli Bejtit

Siç ishte hero i sabrit [durimit] Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] ishte edhe oqean i falënderimit. Sepse në kokën e tij kanë rënë fatkeqësitë dhe belatë më të mëdha. Por gjithashtu, atij i janë dhënë edhe nimetet dhe mundësitë më të mëdha. Në një hadithi sherif thuhet:

“Neve, shoqërisë së Pejgamberëve, na ndodhin belatë dhe fatkeqësitë më të rënda nga mesi i njerëzve. Pas nesh, atyre që më së shumti iu vijnë ato, janë ata që janë më së afërti Pejgamberëve, Salihët [robët e mirë].”¹⁰³

Për ta provuar që Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] është robi më i pjekur dhe më i mbarë, Haku Teala i ka çuar atij

¹⁰² Për transmetim, shih Buhari, Et’ime, 23, Rikak, 17.

¹⁰³ Ibn Maxhr, Fiten, 23; Darimi, Rikak, 67 (nr. 2786).

fatkeqësitë më të rënda. Nëse shikojmë jetën e tij, shohim se është e mbushur me bela dhe fatkeqësi. Babanë e humbi ende pa lindur, ndërsa nënën në moshën 6 vjeçare. Pas dy vitesh, pau vdekjen e gjyshit. Ai ishte dëshmitar i vdekjes së atij që e përkrahu më së shumti kur i erdhi Pejgamberllëku, që e ruajti nga armiqtë e tij, Ebu Talibit [r.a.] dhe ajo nga e cila pati përkrahjen më të madhe Hz. Hatixhes [r.anha] Pos Hz. Fatimes [r.anha], i vdiqën të gjithë fëmijët në moshë të vogël, apo të re.

Të gjitha këto fatkeqësi, i përlotën sytë e bekuar të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.], por asnjëherë nuk u dëgjua nga gjuha e tij ndonjë gjykim për kaderin [caktimin] e as ndonjë britmë vajtimi. Asnjëherë nuk u rrëzua e as nuk u lëkund përballë të gjitha këtyre fatkeqësive, por vetëm duroi [sabër].

Nga fillimi i shpalljes e më vonë, u kërcënua me vdekje, u torturua, u fye e u përqesh nga populli i vet, fisi i vet dhe akrobatë më të afërm, vetëm sepse ftonte njerëzit në shpëtim. Nuk mbeti me kaq, ata që nuk kanë mundur të durojnë prezencën e tij, kanë bërë edhe plane për ta mbytur.

Në të gjitha këto mundime, duke bërë sabër [duruar], më në fund Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] u detyrua të shpërngulet nga vendi ku lindi e ku jetoi 50 vite të jetës së tij. Por mushrikët, përdorën çdo mundësi që patën për ta penguar edhe hixhretin/ shpërnguljen e tij. Por, të gjitha këto gracka dështuan. Edhe pas gjithë këtyre, disa herë luftuan kundër tij.

Në këto luftime me mushrikë, Resulullahu [s.a.v.s.] përjetoi çaste të vështira dhe shumë herë kaloi rreziqe për jetë. Gropuan edhe hendek për ta mbrojtur Medinen. Mbeti i uritur me ditë të tëra. Edhe në atë gjendje,

asnjëherë nuk tregoi neveri, por çdoherë tregoi durim [bëri sabër]. Sepse ai e dinte se ai që bën sabër [duron], fiton.

Kështu, Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] ndaj çdo lloj fatkeqësie që i ka ndodhur gjatë kësaj periudhe jetësore, është ballafaquar me durim, mbështetje/ tevekul, zell, dhe besim. Sa më shumë që rriteshin fatkeqësitë, aq më shumë i rritej fuqia për t'i përballuar.

Armiqtë u përulën, u rrëzuan, para këtij sabri; shumica prej tyre duke qenë armiqë, e pranuan Islamin dhe u rreshtuan në rreshtat/ safat e Resuli Ekremit [s.a.v.s.].

Shukri [falënderimi] i Ehli Bejtit

Siç bënte sabër [duronte] në fatkeqësi, Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] për çdo të mirë dhe nimet [dhuntë] që i vinte, falënderonte. Zaten, në çdo gjendje ai ishte në falënderim. Në asnjë rrëfim, nuk është dëgjuar se është ankuar apo brengosë. Edhe kur ishte i sëmurë rëndë, vazhdimisht gjindej në shukr [falënderim].


Hz. Ajshja [r.anha] tregon:

“Një ditë Resulullahu [s.a.v.s.] u sëmurë dhe filloi të sillej nëpër shtrat. Unë i thash: “Po të na binte kjo sëmundje ndonjërit prej nesh, do të ankoheshim shumë.” Resuli Ekrem [s.a.v.s.] mu drejtua kështu:

“Mos e harro se muminëve [besimtarëve] iu vijjnë lloj-lloj ngushtimesh a mundimesh. Një therrë po t’i hyjë, apo të ketë ndonjë dhimbje në trup, Allahu Teala atij mumini/ besimtari i falë një gjynah dhe në ahiret ia ngritë pozitën për një nivel më lartë.”

Si përfundim...

Sejjidët në ditët e sotme, atyre që iu ka hije ta tregojnë dhe jetojnë ahlakun e gjyshit të tyre në shembullin më të mirë, duhet të jenë shembull i bukur për Umetin e Muhammedit. Sejjidllëku është dhuratë e Allahut [xh.sh.], është një nimet [dhunti] dhe falënderimi i këtij nimeti [dhuntie] është t'i përmbahesh sunnetit të Resulullahut [s.a.v.s.]. Sunneti i tij jetohet duke ndjekur dijen dhe rrugën e miqve të Allahut dhe duke mos u ndarë prej saj. Përndryshe, vetëm lidhja që rrjedh nga gjaku nuk të çon në shpëtim. Përkundrazi, nëse kjo veçanti nuk plotësohet me atë që i takon, është përgjegjësi dhe dëm i madh.



KAPITULLI I SHTATË

PROVUESHMËRIA E EHLI BEJTIT

Rruga e afërsisë së Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]

Rruga e vetme për afërsinë dhe dashurinë ndaj Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] është imani [besimi], pastaj takvaja [devotshmëria]. Që afërsia që rrjedhë nga lidhja e gjakut të ketë efekt, duhet të shoqërohet me iman [besim] dhe takva [devotshmëri]. Nderi i të afërmeve të Resulullahut [s.a.v.s.] ka rrjedhur nga dija, vepra dhe ahlaku i bukur. Mos ta harrojmë edhe këtë se duke qenë të të njejtit fis me Resuli Ekremi [s.a.v.s.] kishte nga ata që ishin pa iman dhe që kishin rënë më poshtë se shtaza. Pra, për shpëtim nevojitet së pari imani dhe pastaj të plotësojmë me kujdes kushtet e imanit. Djali i Nuhut [a.s.] nuk besoi dhe nuk hyri në radhët e besimtarëve, por i Madhi Allah [xh.sh.] iu drejtua Hz. Nuhut [a.s.]:

“Do ta shpëtojmë familjen tënde” por atë nuk e shpëtoi. Hz. Nuhu [a.s.] tha:

“O Rabi im, biri im është nga familja ime” duke thënë këtë, Allahu Teala iu drejtua:

“O Nuh, ai nuk është nga familja jote.” [11-Hud: 45-46]. Pra, nuk i mjaftoi të qenit djali i peygamberit, sepse as vlera nuk iu shtua e as nuk u ngrit.

Kur u shpall ajeti:

“Kujdestarët e saj [Qabes] janë vetëm ata që ruhen - të devotshmit.” [8-Enfal: 34], Hz. Resulullahu [s.a.v.s.] shtoi:

“Miqtë e mi janë vetëm ata që janë të devotshëm”¹⁰⁴, duke cekur se esenca është në iman [besim] dhe takva [devotshmëri]. Në një hadith tjetër, është thënë:

“Të gjithë të devotshmit, konsiderohen familje e Muhammedit.”¹⁰⁵

Selman Farisiu [r.a.] u veçua në mesin e as'habëve me besnikëri dhe dashuri, duke u përfshirë edhe në mesin e Ehli Bejtit. Kështu, në betejën e Hendekut, me një politikë delikate dhe me besnikëri hyri në zemrat e të gjithë as'habëve. Muhaxhirët me thënien:

“Selmani është prej nesh” e konsideruan atë si njërin prej tyre. Edhe Ensarët thanë:

“Jo, në të vërtetë Selmani është prej nesh, ata kanë dashur ta përvetësojnë.” Atëherë vet Resulullahu [s.a.v.s.] hyri ndërmjet tyre, duke u thënë:

“Selmani është prej nesh, prej Ehli Bejtit tonë”,¹⁰⁶ e mori atë në atë rreth të vërtetë; e futi në atë

¹⁰⁴ Hakim el-Mustedrek, 2/28; Ibn Kethir, Tefsiru Kurani-Adhim, 4/51.

¹⁰⁵ Taberani, el-Muxhemus-Sagir, nr. 318.

¹⁰⁶ Ibn Sa'd, Tabakatul Kubra, 1/59; Hakim el-Mustedrek, 3/598.

grup që do të përmendet për të mbarë deri në Ditën e Kijametit.

Në esencë, çdokush mund të fitojë nderin me iman [besim], dashuri dhe takva [devotshmëri]. Kjo derë është e hapur për çdokënd.

Pra, Bilal Habeshiu, Selman Farisiu, Suhejb Rumi [r.anhum], me nderin e afërsisë së Resulullahut [s.a.v.s.] në esencë janë nderuar më së shumti nga ndikimi i imanit [besimit], devotshmërisë dhe muhabetit [dashurisë]. Ebu Lehebi u privua nga ky nder pikërisht nga mungesa e imanit [besimit], takvasë [devotshmëri] dhe muhabetit [dashurisë]. Edhe pse ishte axha i Resulullahut [s.a.v.s.] kjo nuk i dha afërsi ndaj tij, sepse vullneti hyjnor e sheh si esenciale muhabetin [dashurinë] e lidhur për iman.

Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] e dërgoi në Jemen Muadh b. Xhebel [r.a.] dhe doli ta përcjellë për rrugë. I dha edhe disa këshilla. Muadhi [r.a.] kishte hypur në deve, ndërsa Resulullahu [s.a.v.s.] ecte. Kur erdhën deri te vendi i përcjelljes, Resulullahu [s.a.v.s.] iu drejtua:

- **O Muadh! Ndoshta pas këtij viti këtu me mua nuk do të më takosh e nuk do më shohësh.**

Me këtë isharet të Resulullahut [s.a.v.s.], Muadhi [r.a.] mori lajmin e vdekjes dhe filloi të qante. Pas kësaj, Resulullahu [s.a.v.s.] u drejtua për Medine dhe tha:

- **Për mua më të afërmit dhe më të dashurit prej njerëzve, kushdo që është ai, e kudo që ndodhet, janë të devotshmit.**¹⁰⁷

Nëna jonë, Hz. Ajshja [r.anha] ka thënë: “Asgjë dhe askush në botë nuk ka qenë më e këndshme për Resulin e Allahut [s.a.v.s.] sesa ata që kanë qenë të devotshëm.”¹⁰⁸

¹⁰⁷ Ahmed b. Hanbel, el-Musned, 5/235.

¹⁰⁸ Ahmed b. Hanbel, el-Musned, 6/69.

“Nuk mund të qëndrojë në ato vise ku jetojnë sejjidët. Pasiqë ata kanë një lidhje me Resulullahun [s.a.v.s.] dhe bartin atë nder, e unë frikësohem se nuk mund t’iu bëjë nderimin e merituar. – Ubejdullah Ahrar [rha.]

Mburrja me prejardhjen familjare dhe fisnikëria

Prejardhja familjare nuk është arsye për t’u lavdëruar, por për t’u njohur. Për këtë, Haku Teala thotë në ajet:

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.” [49-Huxhurat: 13].

Sipas një tregimi të Ebu Hurejres [r.a.], Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] u pyet:

“Kush është më i nderuari nga mesi i njerëzve?” Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] u përgjeggj:

“Më të nderuarit tek Allahu nga mesi i njerëzve janë ata që janë më të devotshëm.”¹⁰⁹ Allahu Teala nuk e shikon pamjen e jashtme të askujt, mjekrën, sarginë dhe prejardhjen familjare; por shikon zemrat dhe amelet [veprat]. Kështu, Resuli i Allahut [s.a.v.s.] na është drejtuar me këto fjalë:

“Pa dyshim se Allahu nuk shikon në fytyrat dhe pasurinë tuaj. Por Ai shikon në zemrat dhe amelet (veprat) tuaja.”¹¹⁰

¹⁰⁹ Buhari, Tefsir, 12.

¹¹⁰ Muslim, Birr, 10; Ibn Maxhe, Zuhd, 9 (nr. 4143).

Allahu Teala shikon nijetin [qëllimin] e njerëzve. E jo sojin apo racën, por i jepë rëndësi devotshmërisë, ibadetit [adhurimit] dhe nënshtrimit.

Edhe për sejjidët, përzgjedhja e rrugës së devotshmërisë është më e drejta dhe më e dobishmja. Sepse lavdërimi i njerëzve me sojin e tyre, me baballarët dhe gjyshërit dhe të veçohen e të shiten para të tjerëve është nga injoranca dhe budallallëku. Për këtë, Resuli i Allahut [s.a.v.s.] kështu ka paralajmëruar tërë njerëzimin:

“O njerëz, ose do të largoheni nga lavdërimi me të parët tuaj, të cilët kanë vdekur e janë bërë shkumb e hi në xhehenem, ose tek Allahu Teala do të jeni edhe më poshtë se miza që rrotullohet me hundë rreth fliqësisë.”

“Allahu Teala largoi nga të gjithë ju mburrjen e xhahilijetit, e tashmë, të gjithë njerëzit, ose janë muminë [besimtarë] të devotshëm ose të devijuar, të shfrenuar e fatzi. Të gjithë njerëzit janë të bijtë e Hz. Ademit, ndërsa Ademi është krijuar prej dheut.”¹¹¹

Transmetohet nga Ukbe b. Amir [r.a.] se Resuli i Allahut [s.a.v.s.] ka thënë:

“Pa dyshim se soji juaj nuk është shkak për ta sharë dikë. Të gjithë jeni të bijtë e Ademit. I ngjani njëri-tjetrit. Askush nuk dallon nga tjetri përveç me besim dhe takva [devotshmëri]. Ai që ka gjuhë të prishur, është dorështrënguar dhe pa ahlak i mjaftojnë si dëm.”¹¹²

Gjatë historisë, nga Ehli Bejti kanë dalë shumë dijetarë të mëdhenj, velijë, ushtarakë e burrështetas. Ata nuk janë

¹¹¹ Ebu Davud, Edeb, 110 (nr. 5116).

¹¹² Ahmed b. Hanbel, el-Musned, 4/158.

ndarë nga rruga e Allahut Teala dhe Resulullahut [s.a.v.s.] dhe i kanë shërbyer njerëzve. Kjo është rruga e drejtë.

Siç dihet, Kabili ishte djali i Hz. Ademit [a.s.] dhe Kenani i Hz. Nuhit [a.s.] Këta nuk i shpëtoi nga kufri [mosbesimi] fakti që kishin baballarët pejgamberë. Për këtë arsye, askush të mos lavdërohet me sojin dhe racën. Të merret parasysh se Kabili dhe Habili patën prindë të njëjtë. E rëndësishme nuk është se nga kush vjen njeriu, por se si jeton. Gjithashtu, lavdërimi me baballarët e gjyshërit, se kanë qenë salihë [robë të mirë] apo dijetarë, është i pavend dhe jo e mençur, por është e rëndësishme të bëhen salihë [robë të mirë] e të ditur si ata, e të mundohen të ndjekin rrugën e tyre. Për këtë, e pyetën Resuli Ekremin [s.a.v.s.]:

“Kush është më i mençuri dhe më i nderuari nga njerëzit? Resulullahu [s.a.v.s.] u përgjigj:

“Më të nderuarit janë ata që më së shumti përkujtojnë vdekjen dhe përgatiten më së shumti për të.”¹¹³

Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] është shembull

Nuk është e hijshme që dikujt që Allahu Teala i jep nimete [dhunti], të shoh veten më të lartë e të lavdërohet. Pra, kjo është haram [e ndaluar] e gjynah [mëkat]. Sepse, pjekuria dhe përsosmëria i takon vetëm Allahut [xh.sh.] Te çdokush që shfaqet cilido lloj nimeti [dhuntie], vlerë e lartë dhe përsosmëri, le ta dijë se është prej Allahut Teala. Në këtë kuptim, të tregohet nimeti

¹¹³ Ibn Maxhe, Zuhd, 31 (nr. 4259).

është e lejueshme dhe është një mënyrë falënderimi. Kështu, siç ceket në ajeti kerim:

“Dhe nimetet e Rabit tënd përmendi me mirënjohje dhe falënderim.” [93-Duha: 11], në një mënyrë urdhërohet që nimetet t’i kemi ndërmend vazhdimisht. Qëllimi i përmendjes së nimetit, është për të biseduar me fjalë për nimetin dhe për të ekspozuar nimetin në vepër. Veprimi i këtij lloji njihet si falënderim për nimetin. Edhe pse urdhëri që del nga ky ajet, i është drejtuar Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] vlenë për të gjithë njerëzit. Pra, këtë ajet mund ta kuptojmë kështu: në momentin që e kemi një nimet, duhet ta shohim si dhuratë nga xhymertllëku [bujaria] dhe mëshira e Rabit. Kështu, nimetet e Rabit duhet t’i përmendim me fjalë dhe vepra, mos t’i fshehim, por t’iu përgjigjemi me falënderim [shukr].

Kështu që, një njeri që është shpërblyer me nimete, ato nuk duhet të jenë temë e lavdërimit të tij, por si në çdo çështje tjetër, edhe këtu duhet ta marrim shembull Hz. Pejgamberin [s.a.v.s.] Për këtë ai thotë:

“Unë jam zotëriu i të gjithë njerëzve, por në këtë nuk ka mburrje apo lavdërim.”¹¹⁴ Domethënë, se Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] nuk e ka përdorur këtë nimet për lavdërim, siç e përdorin shumica e njerëzve. Sepse, krenaria e Zotëriut tonë Resulullahut [s.a.v.s.] nuk është të qenit më i zgjedhuri nga bijtë e Ademit, por të qenit më i afërti me Allahun Teala.

¹¹⁴ Ibn Maxhe, Zuhd, 37 (nr. 4308); Ahmed b. Hanbel, el-Musned, 3/2.

Nëse gjyshi më kapë për jake...

Një ditë Hz. Davud Tahi [k.s.] e luti Hz. Xhafer Sadikun [r.a.]:

- O nipi i Resulullahut! Kam zemrën shumë të thyer, a më këshillon?" Hz. Xhaferi [r.a.] i tha:

- O Davud! Ti je zahid [asket] i kohës tonë, çfarë nevoje ke për këshillën time?"

- O nipi i Resulullahut! Ti e bartë gjakun e bekuar të Zotërisë sonë, Pejgamberit [s.a.v.s.] Je më i ngrituri nga mesi i njerëzve. Për këtë arsye, a nuk ishte dashur të na këshillosh të gjithëve? Menjëherë pasi Davud Tahi [k.s.] i tha këtë, Hz. Xhafer Sadiku [r.a.] i tha:

- O Davud! Frikësohem se në Ditën e Kijametit, gjyshi im Resulullahu [s.a.v.s.] më kapë për jake, e më pyet se pse nuk i ke shërbyer dinit islam siç meriton? Nuk bëhet shërbim Islamit me prejardhje e soj të mirë, kjo bëhet duke zbatuar urdhërat e Allahut Teala dhe duke u larguar nga ndalesat e Tij. Kur dëgjoji këto fjalë, Davud Tahi [k.s.] filloi të qajë dhe tha:

- Ja Rabbi! Kur një njeri që bartë gjakun e bekuar të Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] dhe është i nderuar me këtë, e gjindet në këtë frikë, kush është Davudi që t'i pëlqejë punët dhe ibadetet [adhurimet] që ka bërë?

Paralajmërimi i

Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.]

Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] e paralajmëroi fisin e vet:

"O shoqëria e Kurejshëve, në Ditën e Kijametit kur çdokush do të vie me amele (vepra), ju mos ejani duke pasur dunjanë [këtë botë] të ngarkuar në qafë.

Atëherë mos thirrni 'Ja Muhammed, Ja Muhammed!' [të lypni ndihmë]. Sepse edhe unë do t'iu them kështu: nuk shikojë në anën e juaj, dhe ju them 'jo.'¹¹⁵

Resulullahu [s.a.v.s.] duke u drejtuar kështu, ju ka tërhequr vërejtjen se nëse i mbështeten dunjasë [kësaj bote], atëherë nuk do të kenë asnjë dobi prej saj.

Pasi është shpallur ajeti:

"Dhe paralajmëro ti familjen tënde më të afërt." [26-Shuara: 214], Resuli Ekrem [s.a.v.s.] e ftoi tërë fisin në iman [besim] dhe amele [vepra] të mira [salih] dhe në fund ka thënë:

"O bija e Muhammedit - Fatime dhe o bija e Abdul Mutalibit, halla e Muhammedit - Safije, punoni amele të mira për vete [se nëse nuk keni amele/ vepra] unë nuk mund të pengojë diçka që mund t'iu vie prej Allahut Teala"¹¹⁶ kështu na ka tërhequr vërejtjen edhe neve.

Ai që gjithë këto kupton, merr vesh që nderi është në takva dhe në modesti, nuk shikon me syrin e vetpëlqimit, e as të nënçmimit për askë dhe nuk tregon mendjemadhësi.

Në ahiret, ka shefat [ndërmjetësim]; muminëve gjynahqarë [besimtarëve mëkatarë] do t'iu bëjnë shefat [ndërmjetësojnë] në krye pejgamberët, edhe ata robë salihë që kanë lejen nga Allahu i Madhërishëm [xh.sh.] Është e natyrshme që gjendja më e lartë dhe kompetenca e shefatit do t'i jepet Hz. Pejgamberit [s.a.v.s.] të gjithë njerëzit do të drejtohen në shefatin e tij. Të gjithë muminët do të përfitojnë nga ky shefat. Por, Hz.

¹¹⁵ Buhari, Edebul Mufred, nr. 897.

¹¹⁶ Buhari, Vesaja, 11; Muslim, Iman, 89.

Pejgamberi [s.a.v.s.] ka ndaluar që pa punuar asnjë amel të mirë, të mbështetemi vetëm në prejardhjen familjare dhe të lavdëruarit me të parët. Për këtë temë, edhe një vërejtje është kështu:

“Vepra e keqe, që e lë vepruesin prapa, nuk e çon përpara prejardhja familjare.”¹¹⁷

Ai i cili lavdërohet dhe mburret me kënaqësinë e Allahut dhe vlerat e larta, nuk i posedon këto të dyja.

Sipas transmetimit të Ebu Hurejres [r.a.], Hz. Pejgamberi [s.a.v.s.] iu është drejtuar kështu:

“Në Ditën e Kijametit, Allahu Teala do të thotë kështu: pa dyshim se unë krijova një neseb [prejardhje familjare] dhe iu caktova juve në një neseb [prejardhje familjare]. Unë ju vendosa në mesin e më të ndershmëve dhe më të devotshmëve, por ju nuk e pranuat këtë por thatë: ‘jam filani i biri i filanit’. Sot unë po e ngris lartë nesebin [prejardhjen] tim, e po ulë shumë poshtë [prejardhjen] nesebin që keni trilluar ju. Ku janë të devotshmit? Ku janë të devotshmit?”¹¹⁸

Pse mburrja?

Allahu Teala në këtë ajeti-kerim na tregon se ku duhet kërkuar krenarinë dhe nderin:

“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.” [49- Huxhurat:13].

Arsyeja e shpalljes së këtij ajeti është:

Hz. Bilali [r.a.] në atë kohë thirrte ezanin dhe bënte muezinllëk, kur Haris b. Hisham, Suhejl b. Amr dhe Halid b. Usejd nga të parët e Kurejshëve thanë:

¹¹⁷ Ebu Davud, Ilmi, 1; Ahmed b. Hanbel, el-Musned, 2/252.

¹¹⁸ Hakim, el-Mustedrek, 2/464; Taberani, el-Muxhemus-Sagir, nr. 643.

“A ky skllav do të na bënë muezinllëk neve?” Me të dëgjuar këtë, Resuli Ekremi [s.a.v.s.] iu tërhoqi vërejtjen kështu:

“Allahu Teala e largoi nga ju mburrjen e xhahilijetit. Të gjithë jeni të bijtë e Hz. Ademit. Ndërsa, Ademi është i krijuar prej dheut.”¹¹⁹

Një person që bartë një përgjegjësi pa ditur fare për te, atë do ta fusë në veprimtari të hutuar. Sejjidët që bartin një përgjegjësi, duhet ta dijnë atë dhe në asnjë mënyrë këtë trashëgimi të vlefshme mos ta fusin në ndonjë veprimtari të mangët e të prishur. Duhet të jenë të dinjitetshëm, dhe të butë ndaj njerëzve si dhe t'i përqafojnë këto veti. Duhet të jenë të kujdesshëm për çdo hap që hedhin, ndërsa veprimet e tyre të mos nxisin ndonjë fjalë në kujtimin e Ehli Bejtit. Të jenë shembull në ahlak në mesin e njerëzve.

Kur Selman Farisiu [r.a.] kishte dëgjuar se Kurejshët po lavdërohen me të parët e tyre, iu tha:

“Unë nuk kam ndonjë anë për lavdërim. Sepse unë jam krijuar nga sperma [një pikë uji]. Në fund do të bëhem një lesh që kundërmon. Pastaj, në Ditën e Kijametit do të shkojë në peshore. Nëse më shumë rëndon sevapi, jam njeri i mirë, nëse gjynahet më peshojnë më shumë, jam njeri i keq.”¹²⁰

Sa bukur kanë thënë të parët tonë:

Mos u lavdëro me bukurinë, një puqërr dhe më s'e ke,

Mos u lavdëro me pasuri, një shkëndijë dhe më s'e ke.

¹¹⁹ Ebu Davud, Edeb, 110 (nr. 5116); Tirmidhi, Menakib, nr. 3955.

¹²⁰ Gazali, Ihyau-Ulumid-Din, 3/1951; Kimya-yi Saadet, f/ 550.

Me çfarë uji do ta pastrosh egon e ndyrë?

Si mund të mburret njeriu me krijimin e tij nga uji e dheu! Sikur që njeriu ka nevojë për nënën dhe rrethin kur lindë i pafuqishëm, ashtu edhe kur këputet nga fuqia dhe forca, prapë ka nevojë për rrethin. Kur e kapë sëmundja e vdekjes, atëherë mbështetet në faljen e Allahut Teala. Pasi që kthimi ynë është te Allahu Teala, edhe ne patjetër duhet t'i nënshtrohemi dhe të ikim nga ndalesat e Tij.

Një ditë Bajazid Bistamiu [k.s.] duke kaluar nga një vend, para tij doli një qen i lagur dhe u shkund. Për të mos i pikur ndonjë pikë në teshat e tij, Hazreti e mblodhi xhyben dhe u tërhoq pas. Qeni filloi të flas:

“Po të kishte pikur ndonjë pikë uji nga unë, do ta kishe larë me ujë të pastër dhe do ta pastroje rroben. Por duke mbledhur xhyben, rave duke parë veten më të pastër dhe më të ngritur se unë. Tash atë ego, me çfarë uji do ta pastrosh?”¹²¹

Prej të mëdhenjve, Muhammed b. Vasi [k.s.] njëherë e pau djalin e tij duke ecur me kryeneqësi. Kështu ia tërhoqi vërejtjen:

“A e di ti kush je? Nëna jote ka qenë robëreshë që e kam blerë për 20 dukatë. Më mirë do të ishte sikur babai yt të mos gjindej në mesin e myslimanëve. E ti, që je krijuar nga një pikë sperme, për ç'arsye kjo mendjemadhësi e kjo mburrje?”¹²²

Tavusi [r.a.] duke e parë një njeri duke ecur me kryeneqësi, i tha:

¹²¹ Mevlana Safi, Reshehat, f. 192.

¹²² Kushejri, Risale, f. 150; Gazali, Ihjau-Ulumid-Din, 3/ 1945.

“Kjo nuk është ecja e atij që e din se çfarë bartë në barkun e tij.”¹²³

Ahnef b. Kajs [r.a.] thotë:

“Shumë çuditëm se si mburret njeriu që vjen nga rruga e urinës.”¹²⁴

Hz. Zejnelabidini [r.a.], i biri i Hz. Husejnit [r.a.] thotë:

“Ata që janë mendjemdhej, më duken shumë të çuditshëm. Ata që kanë ardhur prej një pike, dhe që e dijnë se do të bëhen qelbësirë, prapë janë kryeneç; në ç’siguri mbështeten?”¹²⁵

Gracka e madhe e shejtanit

Arifi i madh Imam Gazaliu [rha] në veprën e tij ‘Ihjau Ulumid-Din’, tregon se si shejtani fuste në grackë disa sejjidë që vinin nga soji i Hz. Aliut [r.a.]:

“Shejtani me këtë mendim donte të mashtronte disa sejjidë që vijnë nga soji i Hz. Aliut [r.a.]: ‘Ata që dojnë të parët, i dojnë edhe evladët e tyre’. Allahu Teala siç ka dashur të parët tuaj, ju don edhe juve. Pra ju nuk keni nevojë të bëni fare ibadet [adhurim] as të nënshtroheni.’

Nëse dikush futet në kësi lloj mendimesh, duhet ta ketë ndërmend Hz. Nuhin [a.s.], djali i të cilit Kenani nuk besoi, edhe pse ky deshi ta shpëtonte me anijë, nuk mundi ta hypë aty dhe i biri iu mbyt në ujë me të gjithë qafirët. Pastaj Hz. Nuh [a.s.] tha:

“O Rabi im, biri im është nga familja ime.” [11-Hud: 45], Allahu Teala iu drejtua:

¹²³ Gazali, Kimya-yi Saadet, f. 564.

¹²⁴ Gazali, Ihjau-Ulumid-Din, 3/ 1943.

¹²⁵ Ibnul Xhevzi, Sifatul Safue, 1/448; Bursevi, Ruhul Bejan, 3/136.

“O Nuh, ai nuk është nga familja jote, ai ka bërë punë të keqe.” [11-Hud: 46].

Siç shihet, të lihen veprat dhe mbështetja në sigurinë vetëm nga të parët dhe lavdërimi me ta është një gabim dhe mashtrim i madh. Allahu Teala e don atë që nënshtrohet e jo kryeneçin.

Ai që mendon se do të shpëtojë në saje të të parëve të vet, është sikur babai i dikujt të hajë e ai të mendojë se është i ngopur, të pijë ujë e ai të mendojë se i ka kaluar etja, të lexojë e ai të mendojë se do të bëhet dijetar, të shkojë në haxh e ai të mendojë se do të bëhet haxhi.¹²⁶

Hz. Aliu [r.a.] thotë: “Në të vërtetë, njerëzit nuk janë evladët e baballarëve të tyre, por janë evladët e veprave të veta.”¹²⁷

Pa dyshim, Islami nuk njeh askënd në bazë të pasurisë, sojit apo pozitës. Këto janë të rrejshme dhe të përkohshme. Grada e secilit është e lidhur me vendin që ka tek Allahu [xh.sh.] Pra, lartësia matet me atë se sa je drejtuar kah Allahu [xh.sh.] dhe sa e mbanë Atë më së larti ndaj çdogjëje. Çdo gjë tjetër është e zbrazët, e abroguar dhe vlera e saj buron nga kundërshtimet.

Shejh Sadiu [k.s.] tregon kështu:

Dëgjova një beduin duke i thënë djalit të tij:

“Biri im! Do të thonë në Ditën e Kijametit: ‘Çka fitove?’ Nuk do të thonë ‘nga cili soj ke prejardhjen?’ Domethënë të pyesin për amelet [veprat]. Nuk do të pyetesh për prejardhjen me pyetje ‘Kush është baba yt?’¹²⁸

¹²⁶ Gazali, Ihjau-Ulumid-Din, 3/ 2022.

¹²⁷ Gazali, Ihjau-Ulumid-Din, 3/ 2253.

¹²⁸ Shejh Sadi, Gylistan, f. 233.

Lëri origjinën, sojin e prejardhjen. Nëse ke një dhunti, tregoje. Trëndafili është bërë nga therra; Hz. Ibrahim [a.s.] prej Azerit.¹²⁹

Në këtë kuptim janë edhe këto bejte të famshme të Hz. Aliut [r.a.]:

*“Njerëzit kanë fytyra që përngajnë njëra-tjetrës,
Baba i tyre është Ademi, e nëna Hava.
Njëri i ngjanë tjetrit, edhe shpirtat përkujtojnë njëri-tjetrin,
Kanë gjymtyrë e eshtra të krijuara në Ademin e Havën.
Po të kishte ndonjë nder nga kjo origjinë,
Atëherë uji e balta do të duhej të lavdërohen.
Vlerat e larta janë vetëm për ata që posedojnë dije,
sepse ata,
Janë në hidajet (udhëzim), dhe iu tregojnë të drejtën
atyre që kërkojnë hidajet (udhëzim).
Vlera e secilit janë veprat e tij të mira,
Mbi veprat e njerëzve ka dukuri (alamete).
Prapa çdo kontradikte gjendet diçka që nuk dihet,
Edhe injorantët janë armiqë të dijetarëve.”¹³⁰*

Këshilla e Jakuti Arshit një sejjidi

Imam Sharani [k.s.] tregon: Shejhu im Muhammed Shenavi [k.s.] më dëftoi këtë tregim:

Derisa një sejjid ishte ulur pranë Shejh Jakuti Arshi [k.s.], vinin njerëzit dhe ia puthnin dorën Shejh Jakuti Arshit [k.s.]. Ndërsa për sejjidin që ishte pranë, nuk

¹²⁹ Shejh Sadi, Gylistan, f. 282.

¹³⁰ Kurtubi, el-Xhami li Ahkemil Kuran, 8/309.

tregonin ndonjë nderim. Atëherë, atij i erdhi rëndë dhe prishi fytyrën. Me të parë këtë, Shejh Jakuti Arshi [k.s.] i pëshpëriti në vesh sejjidit:

“O sejjidi im! Këta që po më nderojnë mua; kjo është për shkak se unë me ahlak, jam në përputhje me gjyshërit e tu. Unë ju përputha gjyshërve tu, ndërsa ti gjyshërve të mi... [Domethënë, ti mbete xhahil [injorant] si gjyshërit e mi]. Për këtë arsye, më nderuan mua e jo ty.”¹³¹

Këta pesë njerëz janë më të nderuarit nga mesi i njerëzve:

1. Sejjidi që pason sunnetin
2. Fakihu sufi
3. Pasaniku modest
4. Fukaraja falënderues
5. Alimi zahid.

Ebu'l-Husejn Nuri [k.s.]

¹³¹ Sharani, el-Envarul Kudsije, 2/49.

